



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Teknologji Informacioni”
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Elson AGASTRA

Dr. Alketa GREPCKA

Shkurt / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: “Teknologji Informacioni”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Teknologji Informacioni”
4	Urdhër/VKM i licencimit:	VKM nr. 518, datë 30.06.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	(28+27+26) = 81
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Korçës u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë.07.01.1992. Në vitin 1994 atij iu dha emri Universiteti “Fan S. Noli”, universiteti u çel mbi bazën e institutit të lartë bujqësor dhe të filialit të Universitetit të Tiranës me degë të tilla si inxhinieria, ekonomiku e mësuesia. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht në 21.09.2017 me vendimin Nr. 65, nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare. Aktualisht, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë përbëhet nga 4 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje njësitë bazë, të organizuara si më poshtë. (Aneksi 2.22.1 Universiteti Fan S. Noli, organigrama, 2021):

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, që përbëhet nga:

- Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë;
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- Departamenti i Histori Gjeografisë;
- Departamenti i Edukimit.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, që përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Sociale;
- Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
- Departamenti Biologji Kimi;
- Departamenti i Infermierisë;
- Departamenti i Informatikës.

Fakulteti i Ekonomisë, që përbëhet nga:

- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- Departamenti i Menaxhimit;
- Departamenti i Marketing Turizëm.

Fakulteti i Bujqësisë, që përbëhet nga:

- Departamenti i Agrobiznesit;
- Departamenti Agronomisë;
- Departamenti i Agroushqimit.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është njësia kryesore e cila ofron programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”. Njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Informatikës** në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, të cilat japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit. (Aneksi 2.22.1 Universiteti Fan S. Noli, organigrama, 2021). Programi në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL” dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 28.04.2021, Universiteti "Fan S. Noli" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Teknologji Informacioni" nëpërmjet shërbimit në AMS. Bazuar në Urdhrin nr. 72, datë 21. 10. 2021, "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Asoc. Elson Agastra dhe Dr. Alketa Grepcka. Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Shtator 2021 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti i "Fan S. Noli", Korçë për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, po ashtu vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në UK, në datat 18 dhe 19 Tetor 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Fan S. Noli", Korçë. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.01.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4 / 4 Prot, datë 31.01.2022. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë", përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 145/1 Prot, datë 31.01.2022, "Dërgohen komentet për draft raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknologji Informativë”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informativë” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë duke kontribuar në përgatitjen e brezit të ri të specialistëve në fushën e kompjuterave dhe të teknologjisë së informacionit.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbillen me njohuri specifike në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informativë” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit F.S. Noli, Korçë. <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik UK 2016-2020</i> <i>Shtojca 2.4.1 Plani Strategjik Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informativë” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit <i>Shtojca 3.1. Mendimi i Dekanit të FSHNH</i> <i>Shtojca 3.30 Aktiviteti DI Korça Global Digital City 2020</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm GVJ konstatoi përmes konsultime me të gjithë dokumentacionin e venë në dispozicion (rregulloret bazë, dokumentet e strategjisë ekzistuese dhe të përditësuara) si dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të Universitetit Fan S. Noli, Korçë se programi i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në “Planin Strategjik UK 2016-2020”</p> <p><i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik UK 2016-2020</i></p> <p><i>Shtojca 1.3.1 Plani strategjik i zhvillimit të UK 2022-2027</i></p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcakton qartë përparësitë e tij akademike dhe demonstroi që programet e studimit hartohen dhe sigurohen në përputhje me këto të fundit.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit. Institucioni, i mbështetur gjithashtu në disa Strategji Kombëtare, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën e teknologjisë së informacionit. Në strategjinë e përditësuar, Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë ka përcaktuar qartë objektivat e zhvillimit të tij.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.22.1 Organigrama, struktura dhe organika UK 2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
----------	------------------------	--	--	--

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.

Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Objektiva të programit të studimit mund të veçojmë:

- Të krijojë, të transmetojë dhe të zhvillojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor me qëllim zhvillimin e shoqërisë;
- Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në të gjitha nivelet e studimit;
- Të ndihmojë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe madje pretendohet në nivel botëror;
- Të ofrojë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë;
- Të kontribuojë në rritjen e standardeve demokratike të shoqërisë dhe me përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë;
- Të kryejë studime dhe thellime në fusha të veçanta;
- Të ofrojë specializim dhe kualifikim të mjaftueshëm;

Programi i studimit ofron të gjitha aftësitë dhe njohuritë që organizohen sipas skemës së llojit të lëndëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018.

Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë

Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI 2020-2023

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Institucioni, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, dhe në veçanti Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka kryer një studim të tregut të punës për fushën e Teknologjisë së Informacionit. Burimi kryesor i informacionit kanë qenë anketime të drejtpërdrejta me nxënësit e shkollave të mesme si studentë potencial, gjithashtu janë bazuar në të dhëna statistikore të ISTAT si dhe të dhëna të mbledhura përgjatë aktiviteteve inovative dhe teknologjike të realizuara në rajonin e Korçës. Në raportin e përgatitur del qartë kërkesa dhe nevoja në vend e më gjerë për specialist në fushën e teknologjisë së informacionit.

Shtojca 3.12 Studimi periodik i tregut i realizuar nga DI

Shtojca 3.29 Aktivitete Shkencore DI 2021

	<p><i>Shtojca 3.30 Aktiviteti DI Korça Global Digital City 2020,</i> <i>Shtojca 3.33 Anketë Gjurmim Punësimi Zhvilluar DI 2021</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese për këtë program studimi janë të paraqitura qartë në rregulloren e programit të studimit, dhe në veçanti (në kapitullin 3).</p> <p>Bazuar në analizën e programeve të lëndëve, në përgjithësi vërehet një përshtatje e argumenteve të trajtuar, sasisë së orëve në auditor dhe organizimin e tyre në semestra dhe vite akademike, të tilla që të lehtësojnë arritjen e objektivave. Megjithatë, nga analiza e planit mësimor, vihet re mungesa e një aktiviteti “praktik mësimor” përveç atyre të parashikuara për lëndë specifike.</p> <p><i>Mungesa e një lënde “Praktikë mësimor” shihet nga GVJ si një mangësi e këtij plani mësimor.</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2, 2.7.3 Plani Mësimor i Programit të Studimit TI 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UK ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni".</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, i cili ka pesë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Sociale; 2. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës; 3. Departamenti Biologji Kimi; 4. Departamenti i Infermierisë; 5. Departamenti i Informatikës.

Burimet njerëzore: Stafit akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Teknologjisë së Informacionit

Nga të dhënat që jepen në DVV, rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të këtij programi studimi.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në vitin akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij **118 pedagogë gjithsej**, ndër të cilët, **50 janë staf akademik efektiv (PAE)**, nga ku: 2 kanë titullin “Profesorë”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 26 kanë gradën Dr., dhe 21 Asistent Lektorë me Msc; dhe **68 staf akademik me kontratë, (PAK)**, nga ku: 9 kanë titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 kanë gradën Dr. dhe 53 Asistent Lektorë me Msc.

Për vitin akademik 2020-2021, Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimet si më poshtë (Të dhëna të përpunuara nga gjetjet e ASCAL):

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	0
Prof. Asoc.	1	0
Dr./PhD	9	1
Dr. në proces	1	0
Msc.	8	3

Në Departamentin e Informatikës, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (7 pedagogë PAE), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Tab. 1 në RVB	
Prof. Dr.	0
Prof. Asoc.	0
Dr./PhD	3
Dr. në proces	4
Total	7

Lidhur me përbërjen e stafit akademik efektiv të paraqitur më sipër, duhet të theksojmë faktin se ka mospërputhje në të dhënat e deklaruara në tabelën 1 në RVB dhe rolin në departament të paraqitur në tabelat 2. Në tabelat 2, një pjese e stafit akademik me kualifikimin “Msc” (Dr. në proces) janë paraqitur si “Asistent Lektor” çka është konform akteve

	<p>rregullatore në fuqi. Por për një pjesë të këtij stafi, të cilët janë bërë pjesë e stafit akademik të Universitetit Fan S. Noli, Korçë, përpara hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015, të cilët kanë patur statusin “Lektor”, duhej të paraqiteshin akoma me statusin “Lektor” nëse këtë e kishin fituar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të sipër përmendur. Gjithsesi, në të dy rastet, stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë.</p> <p>Burimet Infrastrukturore: Institucioni garanton hapësira të bollshme si auditore, klasa për leksione dhe seminare, laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Zyra për stafin, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj.</p> <p>Shërbime IT: Institucioni ka në përdorim shërbime IT në funksion të mësimdhënies dhe anës administrative të sekretarisë si ESSE 3, MS Teams etj.</p> <p><i>Shtojca 2.1 Vendim për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë, teknologji informacioni, në universitetin Fan S. Noli, Korçë (VKM hapjen program studimi)</i></p> <p><i>Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit</i></p> <p><i>Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB</i></p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, si dhe të Departamentit të Informatikës. GVJ bazuar në RVB, dhe në protokollin e takimeve konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” ofrohet nga Departamenti i Informatikës, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Për sa i përket kodifikimit të programeve/klasifikimit, referuar dhe RVB, GVJ është në dijeni të mospasjes në nivel kombëtar të këtij klasifikimi, i cili do të mundësonte përafrimin me ato të direktivave evropiane. Megjithatë, nga analiza e programeve të lëndëve, ato janë në përputhje me objektivat e këtij programi studimi dhe të ngjashme me ato të institucioneve të tjera kombëtare që ofrojnë programe studimi analoge.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e</p>	<p><i>Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e FSHNH</i></p>

evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e departamentit të informatikës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5



Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e UK, si dhe aktet rregullatore specifike, po ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion, dhe konstaton se UK siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UK ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës. Njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njëra tjetrën. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti I UK</i> <i>Shtojca 1.2 – Rregullorja e UK</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësive Kryesore</i></p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UK ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore. Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën</p>

	<p>përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+. Megjithëse në rajonin e Korçës, nga ana e stafit akademik dhe drejtues u paraqit një vështirësi objektive e hartimit të bashkëpunimeve me institucione që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke mos patur këto të fundit filiale në këtë rajon.</p> <p><i>Shtojca 2.25 Lista e marrëveshjeve aktive UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.26 Lista e projekteve UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.10 Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat profesionale me departamentin e informatikës(di) dhe fakultetin e shkencave natyrore dhe humane(FSHNH) (marrëveshje bashkëpunimi të DE)</i></p> <p><i>Shtojca 2.4.1 Plani Strategjik Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ gjatë analizës së dokumentacionit të paraqitur, nuk vuri re një analizë të mirëfilltë periodike për programin e studimit apo hartimin e raporteve analitike për të analizuar marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi. Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik dhe autoritetet udhëheqëse, vihet re se institucioni vlerëson marrëveshjet aktuale në mënyrë subjektive dhe rezultateve të pritshme teorike, por jo nëse ato janë arritur apo vështirësitë që janë hasur. Nuk ka një procedurë të mirëfilltë për analizën e marrëveshjeve dhe efektivitetin e tyre.</p> <p><i>Shtojca 3.6 Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shënime në vizitë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Referuar dosjes së vetë vlerësimit, institucioni ka në fuqi një sërë marrëveshjesh institucionale, pjesë e të cilave prekin edhe marrëdhënie bashkëpunimi specifike për këtë program studimi. Megjithatë, referuar edhe planit mësimor në tre vitet e fundit, në to nuk është parashikuar një lëndë e mirëfilltë praktike. Praktika konsiderohet ajo e zhvilluar brenda çdo lënde si pjesë laboratorike apo seminare me orientim praktik.</p> <p><i>Shtojca 2.25 Lista e marrëveshjeve aktive UK</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2, 2.7.3 Plani Mësimor i Programit të Studimit TI 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se nga institucioni janë</p>


<p>diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>siguruar trajnime profesionale në koordinim me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar qoftë nga akademia dhe industria. Disa trajnime profesionale të organizuara janë në kuadër workshop-i konferencash të organizuara me objekt kryesor të ndërlidhur ngushtësisht me objektivat formuese të këtij programi studimi.</p> <p><i>Shtojca 3.31.1 Workshop RAEM 2018</i> <i>Shtojca 3.31.2 Konferenca RAEM 2019</i> <i>Shtojca 3.31.3 Konferenca RAEM 2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite.</p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2, 2.7.3 Plani Mësimor i Programit të Studimit TI 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi mësimor i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në Teknologji Informacioni do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri e përparuar e një fushe të punës ose studimit, që përfshin një kuptim kritik të teorive dhe parimeve në fushën e kompjuterave; • Aftësi të përparuara, demonstrim të zotërimit dhe inovacionit, të nevojshme për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar të punës ose studimit; • Menaxhimi i veprimtarive komplekse teknike, profesionale ose projekteve, duke marrë përgjegjësinë për vendimmarrjen në kontekste të paparashikueshme të punës ose studimit. Marrja përsipër e përgjegjësisë për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve dhe grupeve;

	<i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i>								
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e studentëve me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushat e teknologjisë së informacionit, teknologjive elektronike dhe komunikimit dixhital, si dhe në disiplina mbështetëse. Departamenti i Informatikës, synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve. Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi.</p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI</i></p>								
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të cilat pasqyrohen tek syllabuset e çdo lënde të cilat janë në përputhje me ato të programit. Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; – Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; – Formim qytetar të përgjithshëm; – Aftësi bazë për punë kërkimore; – Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; – Aftësim për promovim personal; <p>Përgatitja gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet në nivelin e dytë të studimeve. Kërkesat e tregut të punës për specialistë që diplomohen në këtë profil janë në rritje, ndaj programi i studimit synon plotësimin e tyre me të diplomuar cilësorë.</p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI</i></p>								
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të</p>	<p>Bazuar në ndarjen e veprimtarive në kategori formuese, institucioni ka parashikuar një ndarje për këtë program studimi si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="619 1917 1369 1986"> <thead> <tr> <th data-bbox="619 1917 775 1986">Kategoria</th> <th data-bbox="775 1917 1070 1986">Tipi</th> <th data-bbox="1070 1917 1211 1986">IAL</th> <th data-bbox="1211 1917 1369 1986">Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="4" style="height: 20px;"> </td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Tipi	IAL	Standardi				
Kategoria	Tipi	IAL	Standardi						

studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	A	Lëndë Bazë	16.7 %	15 – 20 %
	B	Lëndë karakterizuese	51.7 %	50 – 55 %
	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	14.4 %	12 – 15 %
	D	Lëndë plotësuese	13.3 %	10 – 15 %
	E	Detyrime përmbyllëse	3.9 %	3 – 5 %

Megjithëse ndarja e lëndëve sipas kategorive të paraqitur në planin mësimor është konform VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në të nuk është parashikuar një lëndë “praktikë profesionale” në kategorinë “D”. Gjithashtu, përqindja totale e lëndëve të kategorisë “A” + “B” është 68.4 % ku sipas të njëjtës VKM duhet të jetë jo më pak se 70%. Gjithsesi, mospërputhja e numrit të krediteve për kategorinë “A” + “B” nuk çënon cilësinë e këtij programi studimi.

Ndërsa nga GVJ vlerëson si mangësi në ofrimin e një programi cilësor, mungesën e praktikës profesionale pranë institucioneve apo kompanive të lidhura me objektivat e këtij programi studimi.

Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI

Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI

Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Bazuar në planin mësimor por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar qartë objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët si në auditor ashtu edhe punim individual. Megjithatë, vërehet se institucioni nuk përdor një metrikë të njëjtë në vlerësimin e ngarkesës në auditor për kredit për lëndë, së paku për lëndë të të njëjtës kategori. Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në tabelat 10 në RVB, duke marrë si shembull lëndë të kategorisë B, në planet mësimore disa lëndë paraqiten me 3 kredite ECTS leksione dhe parashikuar si 30 orë në auditor, pra 10 orë/1 ECTS në auditor, dhe për lëndë të tjera por të kësaj kategorie paraqitet si 2.5 ECTS me 30 orë në auditor, pra 12 orë/ 1 ECTS leksion në auditor. Në mënyrë të ngjashme vërehet edhe për lëndë të kategorive të tjera, dhe për veprimtaritë formues jo vetëm leksione por

edhe ushtrime. Gjithashtu, në plan-programet e lëndëve për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk paraqitet ngarkesa në kreditet për aktivitetet formuese të lëndëve, por vetëm orët që ato parashikojnë në auditor. Pra jepen kreditet totale të lëndëve pa i ndarë ato në kredite për leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj. Në këtë mënyrë është e vështirë vlerësimi i parametrave cilësor të aktiviteteve formuese për secilën lëndë. Në planet mësimore por edhe në programet e lëndëve, në asnjë prej tyre nuk është parashikuar një aktivitet laboratorik. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik i cili u pyet rreth këtij argumenti, u sqarua se pavarësisht se në plan-programet e lëndëve, nuk është parashikuar në zë të veçantë aktiviteti laboratorik, zhvillimi i tyre është i integruar me pjesën e ushtrimeve ku për lëndë karakterizuese zhvillohet në laboratorët e informatikës. Kjo bën të mundur që ushtrimet e parashikuara për lëndën, përveç trajtimit teorik të mirëfilltë, zhvillohen si zgjidhje kompjuterike nga studentët gjatë këtyre seancave ushtrimore.

Edhe pse GVJ e konfirmoi pohimet e më sipërme edhe gjatë takimit me student të këtij programi studimi, sugjeron institucionin të përdori një ndarje formale të aktiviteteve didaktike duke parashikuar edhe laboratorët përkatëse. Në këtë mënyrë është e mundur të vlerësohet edhe nga ana sasiore dhe cilësore zhvillimi i tyre në funksion të përcimit të njohurive.

Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI

Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI

Shënime në vizitë.

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Informatikës, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informaticioni” ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtar, nga të cilës 3 me gradën shkencore “Doktor” dhe 4 me kualifikimin “Master i Shkencave” dhe janë në zhvillim të procesit të kualifikimit për gradën shkencore “Doktor”. Përbërja është në përputhje me nenin 25 të ligjit 80/2015. Departamenti i Informatikës është njësi bazë e FSHNH në UK, që ofron programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informaticioni". Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane përbëhet nga 5 (pesë) departamente konform nenit 23 të ligjit 80/2015. Edhe institucioni i arsimit të lartë, Universiteti Fan S. Noli, Korçë, është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë 21/09/2017.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Informatikës, në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informaticioni” ka të përcaktuar objektivat e Koordinatorit të Programit të studimit. Roli i tij është i përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë. Koordinator i programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informaticioni" është caktuar konform Rregullores së Programit të studimit.</p> <p><i>Shtojca 2.3 Rregullore e Departamentit të Informatikës</i></p> <p><i>Shtojca 2.11 Vendimi për Emërimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane si dhe njësia bazë Departamenti i Informatikës përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet minimale për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Çdo departament kanë së paku 7 pedagog me kohë të plotë nga të cilët të paktën tre janë me grada dhe tituj akademike bazuar në dokumentacionin sipas dosjes RVB.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në vitin akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij 118 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 50 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 68 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik efektiv i fakultetit është;</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 me titull “Profesor”; - 1 me titull “Profesor i Asociuar”; - 26 me gradën shkencore “Doktor” - 1 me titullin “Docent”;

- 20 me kualifikimin “Master i Shkencave” ku një pjesë prej tyre janë student të shkollave të doktoratës;

Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Informatikës që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:

Për vitin akademik **2018-2019, (19 PAE / 3 PAK)**, nga këta me grada/tituj shkencore **10 / 0**;

Për vitin akademik **2019-2020, (7 PAE/ 4 PAK)**, nga këta me grada/tituj shkencore **3 / 2**;

Për vitin akademik **2020-2021, (7 PAE/ 4 PAK)**, nga këta me grada/tituj shkencore **3 / 2**;

Njësia kryesore ku programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” zhvillohet, ka të angazhuar për këtë program staf akademik PAE dhe PAK në tre vitet e fundit si më poshtë:

Viti akademik	PAE	PAK
2018-2019	20	3
2019-2020	21	3
2020-2021	22	3

2.22.2 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNNH-organigrama)

Shtojca 2.2 Rregullorja e Njesisë Kryesore

Shtojca 1.1 Statuti i UK

Shtojca 1.2 Rregullorja e UK

Shtojca 2.24 Programet e Studimit 2020-2021 UK Shtojca 2.23 Staf i Akademik i Universitetit 2021

Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.

Në përbërjen e njesisë bazë, Departamenti i Informatikës ka edhe një personel ndihmës akademik, i cili angazhohet në mbështetjen e aktiviteteve laboratorike në funksion të këtij programi studimi. Edhe pse në planet mësimore nuk janë detajuar orët e ngarkesës laboratorike apo të praktikave, sikurse u konfirmua gjatë vizitës në institucion, ato zhvillohen së bashku me aktivitetet e ushtrimeve dhe kur është e nevojshme, asistohen edhe nga personeli ndihmës akademik.

Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB

2.22.2 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNNH-organigrama)

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në Teknologji Informacioni, Departamenti i Informatikës disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Departamentit të Informatikës</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 40 lëndë të ndara sipas 3 viteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 14 lëndë në vitin e parë; - 14 lëndë në vitin e dytë; - 12 lëndë në vitin e tretë;
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Në vitin e tretë është parashikuar edhe dhe punimi i diplomës ose provimi i formimit me 7 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Megjithatë, në organizimin e planit mësimor, vërehet mungesa e një aktiviteti formues praktik.</p> <p><i>GVJ rekomandon se praktika është e nevojshme për një program studimi në fushën e teknologjisë së informacionit.</i></p>

	<p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Teknologji Informatikë përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Institucioni nuk ka zbatuar një rregull uniform në ndarjen e orëve në auditor për çdo kredit ECTS për tipologjitë e aktiviteteve formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj. Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në tabelën 10 në RVB, vërejmë se ka lëndë që paraqesin një ngarkesë leksionesh me 3 ECTS dhe kanë një ngarkesë prej 30 orë në auditor për këtë aktivitet, pra 10 orë/1 ECTS. Po tek i njëjti plan mësimor, ka lëndë që po për leksione me 2.5 ECTS kanë një ngarkesë në auditor prej 30 orësh, pra 12 orë/1 ECTS.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të mbajë një ndarje uniforme të ngarkesës për kredit dhe nëse gjykon se studenti duhet të ketë një ngarkesë më të madhe apo më të ulët në auditor, të ndryshojnë numrin e krediteve përkatëse.</i></p> <p>Në këtë mënyrë bëhet e mundur vlerësimi cilësor dhe sasior i ngarkesës si për stafin akademik, por edhe për studentët për përfitimin e njohurive përkatëse. Mënyra e vlerësimit të dijeve është e përcaktuar në syllabuset e secilës lëndë dhe përfshinë në përqindje të ndryshme kriteret si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet didaktike; - Pjesëmarrja dhe zhvillimi i laboratoreve; - Projekte dhe detyra kursi; - Testimet të ndërmjetme gjatë zhvillimit të lëndës; - Provimi përfundimtar; <p>Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>Institucioni, dhe në veçanti, Njësia Bazë Departamenti i Informatikës, propozon vit për vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në Teknologji</p>

<p>pranimi, transferimi dhe ekuivalentimi të studimeve.</p>	<p>Informacioni. Të dhëna që shpërndahen në takimet me maturanët e shkollave të mesme, kryesisht të rrethit të Korçës që janë edhe kandidatët potencial të këtij programi studimi. Në rregulloren e njësisë kryesore dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Kriteret specifike dhe mënyrat e vlerësimit dhe njohjen e krediteve propozohen nga njësia bazë dhe janë pjesë e procedurës së ekuivalentimit të njohurive të mëparshme të studentit.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njesisë Kryesore</i></p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Faqe web e UK</i></p> <p><i>Shtojcat 3.27.1, 3.27.2, 3.27.3 Vendime Senati për Miratimin e Kuotave</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën.</p> <p>Nga analiza e detajuar e syllabuseve të lëndëve të këtij programi studim, vihet re se në disa prej tyre është paraqitur lektori (pedagogu i lëndës) dhe jo titullari i saj, lektor që ka kualifikimin “Master i Shkencave”.</p> <p><i>Rekomandojmë, se në zbatim të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, titullar lënde nuk mund të jenë me kualifikimin “Master i Shkencave”. Institucioni, gjithashtu të azhurnojnë literaturën e detyruar në versione të pesë viteve të fundit:</i></p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, por pa e ndarë atë në ngarkesë në auditor dhe jashtë tij. Paraqitet gjithashtu përshkrimi i lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të njohurive. Megjithatë, institucioni në programet e lëndëve nuk ka</p>

	<p>caktuar qartë ndarjen në kredite të aktiviteteve didaktike formuese, por vetëm ngarkesën që ato paraqesin për studentin në total, pra 1 ECTS = 25 orë studimore. Në tabelën përkatëse të planit mësimor të paraqitur në tabelën 12 në RVB, kjo ndarje paraqitet e plotë, edhe pse nuk ka një uniformitet në numrin e orëve në auditor për 1 kredit ECTS. Gjithashtu edhe në shtojcat përkatëse (2.7.1, 2.7.2, 2.7.3) që paraqesin planin mësimor, edhe në këtë rast, nuk kemi paraqitjen e ndarjes së krediteve për leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj. Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar. Megjithatë, edhe pse në këtë shtojcë, nuk është e shprehur qartazi, por nënkuptohet, në syllabuse duhet të paraqitet edhe ndarja në kredite për aktivitetet formues si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, detyra kursi etj., si dhe orët përkatëse të nevojshme në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.23 Të Dhëna për Fondin e Librave në Funkcion të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron. Në veçanti, në fund të vitit akademik, pedagogët e përfshirë në programin e studimit që po analizojmë, hartojnë një relacion përshkrues për të gjitha aspektet e mësimdhënies duke vënë në dukje problematika të hasura dhe sugjeruar zgjidhje për të ardhmen. Gjithashtu, institucioni përdor edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC-ja për përditësimin e programit të studimit. <i>Megjithatë, sikurse vihet re edhe nga pyetësorë e përdorur për të mbledhur informacione rreth programit të studimit dhe nevojave të tregut, edhe pse ka lindur nevoja për më shumë praktikë, ajo nuk është pasqyruar në përditësimet e planeve mësimore.</i></p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>

	<p><i>Shtojca 3.17 Model Analize në fund moduli/lënde</i></p> <p><i>Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Pyetësi Studentor</i></p> <p><i>Shtojca 3.12 Studimi Periodik i Tregut</i></p> <p><i>Shtojca 2.12.1 Proçedura e Ndryshimeve në Planet Mësimore 2021-2022</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ngarkesa e programit të studimit paraqitet në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me VKM nr.41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj.</p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës. Mungesa e praktikave profesionale që të mund të realizohen pranë institucioneve publike apo private shihet nga GVJ si një mangësi për të rritur punësimin e studentëve dhe në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës. Megjithatë, personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve. Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes</p>

	<p>institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashiko një lëndë praktike.</p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.6 Raporti i Përfutimeve nga Murrëveshjet në Funksion të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni janë vlerësuar shumë pozitivisht në disa projekte që kanë marrë pjesë dhe kjo është përdorur si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar. Edhe pse ndarja në kredite ECTS është e tillë që lejon përçimin e njohurive kundrejt objektivave të vet programit të studimit, <i>institucioni nuk ka zbatuar një rregull uniform në ndarjen e orëve në auditor për çdo kredit ECTS për tipologjitë e aktiviteteve formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.</i> Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në tabelën 10 në RVB, vërejmë se ka lëndë që paraqesin një ngarkesë leksionesh me 3 ECTS dhe kanë një ngarkesë prej 30 orë në auditor për këtë aktivitet, pra 10 orë/1 ECTS. Po tek i njëjti plan mësimor, ka lëndë që po për leksione me 2.5 ECTS kanë një ngarkesë në auditor prej 30 orësh, pra 12 orë/1 ECTS.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Planit mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafëruara me programe të ngjashme ndërkombëtare. Megjithatë, sikurse është përmendur edhe në kriteret e më sipërme, kundrejt programeve të ngjashme të ofruara nga IAL kombëtare publike apo private, në këtë program studimi mungon një lëndë "Praktikë profesionale". Nga plani mësimor i paraqitur në tabelën 10 në RVB, rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2136 orë mësimore në auditor, të ndara; - 1059 teori (leksione);

	<p>- 1077 praktikë (ushtrime/laboratorë), ose afërsisht një raport 1:1;</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.28 Programe Studimi të Ngjashme</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informatik.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit, objekt i këtij vlerësimi të jashtëm, është në nivel Bachelor, dhe gati 17% të planit mësimor përbëhet nga lëndë të kategorisë A (Lëndë Bazë) të cilat përfshijnë lëndë të grupimeve matematikë, fizikë e të tjera të ngjashme. Për një pjesë prej tyre, ndryshimet në plane-programet janë shumë të vogla në vite për vetë natyrën e tyre si njohuri bazë. Për këto lëndë vërehet se literatura e detyruar jo gjithnjë është e pesë viteve të fundit. Megjithatë, edhe gjatë vizitës në institucion dhe në takim me stafin akademik, vihet re se edhe në këto lëndë, pedagogët përgjegjës azhurnojnë literaturën plotësuese me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive. Për natyrën e këtyre lëndëve, azhurnimi i literaturës është më i ngadaltë se për lëndë të kategorive të tjera. Megjithatë, vërehet nga stafi akademik një vështirësi në gjetjen e literaturës së azhurnuar në gjuhën shqipe, jo vetëm për këtë grup lëndësh, por në përgjithësi për lëndë të profilit të studimit në teknologjinë e informacionit.</p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.23 Të Dhëna për Fondin e Librave në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 4.6 Manual i përdorimit të librarisë elektronike U-Library</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informatik garanton përfundimin e njohurive, aftësi</p>

<p>garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Programi i studimit përfshin lëndë si “Menaxhimi i Projekteve” në mënyrë që studentët të përftojnë edhe njohuri që mund t’i ndihmojnë në nismat e tyre të mëvonshme në fushën e sipërmarrjes.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëria e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p><i>Shtojca 3.32 Analiza QKA 2019-2020</i></p> <p><i>Shtojca 3.24.1, 3.24.2, 2.24.3 Të dhënat e Gjurmimit të Studentëve të Diplomuar</i></p> <p><i>Shtojca 3.33 Anketë Gjurmimi Punësimi Zhvilluar nga DI 2021</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstaton se njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacionit për të siguruar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit si dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, konsultohet vazhdimisht dhe merr parasysh propozimet e partnerëve nga tregu i punës. Komunikimi është përqendruar në diskutime në lidhje me zgjidhjet software që zakonisht përdoren në industri, si dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për punën në grup.</p> <p><i>Shtojca 2.10 Marrëveshjet e Bashkëpunimit DI</i></p> <p><i>Shtojca 2.25 Lista e Marrëveshjeve Aktive UK</i></p> <p><i>Shtojca 3.24.1, 3.24.2, 2.24.3 Të dhënat e Gjurmimit të Studentëve të Diplomuar</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoj se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit është mbuluar në masë më të madhe, rreth 90%, me staf akademik më së paku gradën shkencore Doktor. Konkretisht:</p> <p>Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim 23 pedagogë gjithsej nga të cilët 20 PAE dhe 3 PAK (87% / 13%).</p> <table border="1" data-bbox="678 745 1278 1151"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0 Prof. Dr.</td> <td>0 Prof. Dr.</td> </tr> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>0 Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>10 Dr./PhD</td> <td>0 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>5 Msc (Dr. në proces)</td> <td>0 Msc (Dr. në proces)</td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td>3 Msc</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim 24 pedagogë gjithsej nga të cilët 21 PAE dhe 3 PAK (88% / 12%):</p> <table border="1" data-bbox="683 1350 1283 1756"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0 Prof. Dr.</td> <td>0 Prof. Dr.</td> </tr> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td>0 Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>12 Dr./PhD</td> <td>1 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>4 Msc (Dr. në proces)</td> <td>0 Msc (Dr. në proces)</td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td>2 Msc</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim 25 pedagogë gjithsej nga të cilët 22 PAE dhe 3 PAK (88% / 12%).</p> <table border="1" data-bbox="687 1895 1287 1957"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	0 Prof. Dr.	0 Prof. Dr.	1 Prof. Asoc.	0 Prof. Asoc.	10 Dr./PhD	0 Dr./PhD	5 Msc (Dr. në proces)	0 Msc (Dr. në proces)	4 Msc	3 Msc	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	0 Prof. Dr.	0 Prof. Dr.	1 Prof. Asoc.	0 Prof. Asoc.	12 Dr./PhD	1 Dr./PhD	4 Msc (Dr. në proces)	0 Msc (Dr. në proces)	4 Msc	2 Msc	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>		
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																												
0 Prof. Dr.	0 Prof. Dr.																												
1 Prof. Asoc.	0 Prof. Asoc.																												
10 Dr./PhD	0 Dr./PhD																												
5 Msc (Dr. në proces)	0 Msc (Dr. në proces)																												
4 Msc	3 Msc																												
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																												
0 Prof. Dr.	0 Prof. Dr.																												
1 Prof. Asoc.	0 Prof. Asoc.																												
12 Dr./PhD	1 Dr./PhD																												
4 Msc (Dr. në proces)	0 Msc (Dr. në proces)																												
4 Msc	2 Msc																												
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																												

1 Prof. Dr.	0 Prof. Dr.
1 Prof. Asoc.	0 Prof. Asoc.
12 Dr./PhD	1 Dr./PhD
5 Msc (Dr. në proces)	0 Msc (Dr. në proces)
3 Msc	2 Msc

Nga analiza e ngarkesës mësimore paraqitur në tabelën e mëposhtme, rezulton se rreth **88%** e ngarkesës përballohet nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe vetëm **12%** nga personeli akademik me kontratë (PAK). Institucioni ka mobilizuar gjithë kapacitetet e tij duke përballuar pjesën kryesore të ngarkesës. Përballimi i ngarkesës kryesisht nga PAE ndikon pozitivisht në formimin e studentëve, duke qenë se ka një disponibilitet më të lartë të personelit akademik për të ndihmuar studentët në realizimin e programit.

<i>Viti akademik</i>	<i>Ngarkesa mësimore PAE</i>	<i>Ngarkesa mësimore PAK</i>
2019-2020	87%	13%
2018-2019	88%	12%
2017-2018	88%	12%

Shtojca 4 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB

Shtojca 2.23 Stafit akademik i universitetit "Fan S. Noli" (stafi akademik i universitetit 2021)

Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e Stafit Akademik të Përfshirë në Programin e Studimit

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Duke analizuar dosjet personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në programin të studimit, rezulton se të gjithë kanë kualifikimin e duhur akademik në nivelin e kërkuar, për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit, ato kanë eksperiencë dhe veprimtari shkencore të gjerë.

Megjithatë GVJ sugjeron që personeli akademik me formimin Master i Shkencave (Msc) të kualifikohet në nivele më të larta si në kërkimin shkencor së paku me gradën "Doktor" e më pas me titujt akademik Prof. Asoc. dhe Prof.

Shtojca 4 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB


	<i>Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e Stafit Akademik të Përfshirë në Programin e Studimit</i>			
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Bazuar në CV e stafit akademik, niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikimet e moduleve të tij. Lektorët punojnë në fushat e kërkimit që përputhen me konceptet e mësuara në programin e studimit bachelor dhe ato përfshijnë elemente të fushës të tyre të kërkimit në lëndë. <i>Shtojca 4 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Njësia bazë, Departamenti i Informatikës angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit. Për këtë departamenti ushtron një rol të veçantë për ekuilibrimin e ngarkesës së personelit në funksion të elementëve të ndryshëm përbërës të programit të studimit. Rezulton se Departamenti i Informatikës, për studentët që mbyllin detyrimet akademike me rezultate të larta, mundëson zhvillimin e temës së diplomës. Punim që ndiqet nga një pedagog i këtij departamenti. Partnerët e biznesit krijojnë mundësi bashkëpunimi si në ide dhe opinione në zhvillimin e programit të studimit sipas nevojave të tregut të punës por edhe në formimin e përgjithshëm të studentëve. <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit 2020-2023</i> <i>Shtojca 3.34 Studentët e Diplomuar me Temë Diplome</i> <i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i> <i>Shtojca 3.18 Shembulli i Orëve të Hapura</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seanceve laboratorike mbështetet prej asistentëve (laborant). Kontributi i tyre dhe i personelit administrativ shkon edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve. Departamenti i Informatikës angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit dhe këtë e konfirmuan edhe studentët gjatë takimit të zhvilluar. <i>Shtojca 3.35 Jetëshkrimi i Stafit Ndihmës Akademi</i> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të ndryshme dhe bashkëkohore të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve. Institucioni tregon vullnet në sigurimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mjedisit të nxënies. Sidomos gjatë periudhës së pandemisë së krijuar nga virusi Sars-Cov-2 (covid-19), institucioni ka hartuar udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie ku ndër to veçojmë përdorimin e platformës Microsoft Teams, Moodle dhe EduMeet.</p> <p><i>Shtojca 2.18 Manual Mësimi Online Training in Microsoft Teams 365</i></p> <p><i>Shtojca 4.9 Manual Moodle</i></p> <p><i>Shtojca 4.10 Manual EduMeet.</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Institucioni ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e mësimdhënies në mënyrë periodike. Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë, ka detyrim vlerësimin periodik të mësimdhënies për stafin akademik. Gjithashtu, monitorimi i cilësisë nuk bazohet vetëm në vlerësimet e zhvilluara nga drejtuesi i njësisë bazë, por bazohen edhe në pyetësorët periodikë të realizuar me studentët. Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, studentët në fund të secilës lëndë apo modul plotësojnë një pyetësor në formë anonime rreth të gjithë aspekteve të mësimdhënies ku ndër të tjera mblidhen mendimet e studentëve rreth:</p> <ul style="list-style-type: none">– Materialeve mësimore, mjaftueshmërinë dhe cilësinë e tyre për të ndjekur dhe kuptuar lëndën,– Aftësitë gjithëpërfshirëse të pedagogut në aktivitetin mësimor;– Përdorimi i metodave multimediale apo ndihmëse inovative në funksion të mësimdhënies,– Aftësitë komunikuese në funksion të përcimit të dijeve tek studentët

	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e të gjithë orëve mësimore/didaktike të parashikuara në planin mësimor; - Gjithashtu, hartohen edhe pyetje që lidhen me studentit dhe frekuentimin e tij të aktiviteteve didaktike apo edhe studimin individual; - Pyetësi përfshin edhe shumë aspekte të tjera të lidhura jo vetëm me mësimdhënien por edhe me të gjithë infrastrukturën në tërësi të institucionit në funksion të përcimit të dijeve; <p>Në vijim të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, hartohen nga personeli akademik edhe raporte të vetë vlerësimit me qëllimin e vënies në dukje të problematikave nëse ka dhe/apo sugjerimeve për përmirësime të mëtejshme. Institucioni ka të ngritur në nivel Universiteti, Sektorin e Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA) i cili ka përgjegjësinë institucionale për monitorimin e stafit akademik. SKVIA bazohet kryesisht në anketimet e studentëve, rezultatet e të cilit hartohen në formë raporti për përdorim të brendshëm të institucionit.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor Studentor 2021,</i> <i>Shtojca 3.13.2 Raport Pyetësi Studentor,</i> <i>Shtojca 3.14 Pyetësi i Stafit Akademik Model</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit periodik jo vetëm të mësimdhënies por në tërësi të të gjithë aspekteve cilësore institucionit, përfshirë këtu ambientet si salla leksionesh/seminarësh, laboratorë, biblioteka etj. Studenti ka të drejtën të ankimojë pranë njësisë bazë, asaj kryesore apo në institucion nëse ndaj tij janë shkelur të drejtat që i lindin nga statusi student pranë këtij institucioni. Procedurat e ankimimit janë të parashikuara si në rregulloren e njësisë kryesore ashtu edhe në atë të njësisë bazë, ku studenti mund të ankimojë vlerësimin apo procedurat e ndjekura për vlerësimin e dijeve të tij.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 3.13.2 Raport Pyetësi Studentor</i> <i>Shtojca 3.14 Pyetësi i Stafit Akademik Model</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në</p>	<p>Struktura përgjegjëse në nivel institucioni për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë është Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI) në Sektorin e Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA). Kjo drejtori,</p>

<p>mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>në fund të çdo viti akademik harton raporte të përvitshme të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte shqyrtohen më pas në Senatin Akademik të institucionit për të dhëna në rang institucioni e më pas, të dhënat specifike për programet e studimi, u shpërndahen njësisë kryesore përgjegjëse. Përtej raporteve të hartuara në nivel institucional nga DKVI, edhe njësitë kryesore dhe ato bazë hartojnë raporte për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në njësitë përkatëse. Të dhënat e raporteve të hartuara në nivel njësie bazë, diskutohen në mbledhjet e kësaj njësie sikurse edhe raportet e hartuara në nivel njësie kryesore gjithashtu diskutohen në nivel dekanati për përmirësimin në vijim të parametrave cilësor.</p> <p><i>Shtojca 1.5 Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 3.7.1, 3.7.2, UNIKO Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Shtojca 2.29 Analiza Vjetore FSHNH</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e ndërgjegjësimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ mbi rëndësinë e përvetësimit të kulturës së cilësisë nga çdo njësi në këtë institucion, Diskutimet e raporteve në nivel të senatit akademik, dekanatit dhe njësisë bazë kanë si një nga qëllimet, informimin e stafit të institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart siguri i cilësisë në përgjithësi dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë në veçanti. Bazuar edhe në nevojat që dalin nga këto raporte, institucioni mundëson plotësimin e tyre në kuadër të rritjes së cilësisë si me zhvillimin e leksioneve të hapura ku pjesëmarrës janë jo vetëm studentët por edhe stafi akademik për të përvetësuar edhe nga eksperiencia e kolegëve të ftuar.</p> <p><i>Shtojca 3.7.1, 3.7.2, UNIKO Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Shtojca 3.18 Shembulli i Orëve të Hapura</i> <i>Shtojca 3.5 Plani i Veprimit për Zbatim e Office 365</i> <i>Shtojca 3.39 Didaktika e Shkencave</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimi, projekteve, detyrave, praktikave, seminarëve dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të parashikuara për lëndë. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite ECTS. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme; provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodatat e vlerësimit janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, kolekiumet, kuizet, projektet, projektet semestrale, pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiket të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë është i disponueshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit. Gjithashtu, për të paraqitur në një këndvështrim plotësues për studentët, njësia bazë dhe ajo kryesore marrin pjesë edhe në aktivitete shkencore si konferenca apo ore të hapura ku studentët ftohen të marrin pjesë.</p> <p><i>Shtojca 3.22 Infrastruktura Lab. në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.29 Aktivitetet Shkencore DI 2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me</p>	<p>Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike. Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrin pjesë në aktivitete të tjera shkencore, por në këto raste, mbështetja ekonomike e institucionit është thuhet e pa përfillshme ose mungon krejtësisht. Në shumicën e rasteve</p>


<p>rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit, stafi akademik i mbulon vetë shpenzimet, ose në rastin më të mirë, mbështetet nga institucionet partnere. Kjo sjell një barrë të lartë ekonomike dhe një pengesë shumë të madhe për stafin akademik për të përparuar në karrierën akademike dhe atë shkencore. Brenda institucionit, stafi akademik më me përvojë përpiqet për të motivuar dhe trajnuar stafin më të ri, apo atë që nuk është i fushës së teknologjisë së informacionit duke hartuar manuale praktike për përdorimin e teknikave dhe metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Shtojca 3.29 Aktivitetet Shkencore DI 2021</i></p> <p><i>Shtojca 3.18 Shembulli i Orëve të Hapura</i></p> <p><i>Shtojca 4.9 Manual Moodle</i></p> <p><i>Shtojca 2.18 Manual Mësimi Online Training in Microsoft Teams 365</i></p> <p><i>Shtojca 4.10 Manual EduMeet</i></p> <p><i>Shtojca 3.42 Trajnimet e Stafit Akademik DI</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personel akademik i institucionit në tërësi. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Edhe pse një pjesë e stafit akademik me kualifikimin “Master i Shkencave” (cikli i vjetër 5-vjeçar në inxhinieri) dhe aktualisht në proces doktore, kanë një përvojë të gjatë mbi 10-vjeçare në këtë institucion si lektor/asistent lektor. Stafi akademik, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve, i përshtat ato me programe të ngjashme të institucioneve homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p> <p><i>Shtojca 2.9 – Jetëshkrimet e Stafit Akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mësimdhënies me anë të implementimit të Pyetësorëve mbi Vlerësimin e Lektorit të Lëndës i cili është një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mësimdhënies. Ky pyetësor mbahet në bazë semestrale. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese. Nga takimi me studentet u konstatua se ky mekanizëm kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë ku mangësitë e studentëve në njohuritë paraprake nga shkolla e mesme, ishin plotësuar me ndihmën e stafit akademik të institucionit</p> <p><i>Shtojca 3.14 Pyetësori i Stafit Akademik Model</i></p>

<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në përgjithësi, personeli akademik në punën e përditshme gjatë procesit mësor, synon të kalojë nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj. Përmes këtyre transformimeve synon të nxiten dhe zhvillohen cilësi si: a) kreativiteti; b) puna në grup dhe komunikimi i ndërsjellë; c) ndërgjegjësimi dhe marrja e përgjegjësi; ç) individualiteti; d) zhvillimin i imagjinatës krijuese dh) zhvillimi i iniciativës për të vepruar; e) Të shprehurit korrekt me shkrim dhe me gojë. Në përgjithësi, gjatë periudhës së zhvillimit të aktivitetit didaktik online, stafi akademik ka rritur rëndësinë e zhvillimit të projekteve të lëndëve nga ana e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në diskutim edhe me pedagogët, GVJ konstaton se mësuesit në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit dhe zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë realë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga të dhënat në RVB si dhe vizita në institucion, vihet re se aktiviteti didaktik i këtij programi studimi zhvillohet në ambiente të bollshme si për aktivitetet teorike ashtu edhe për ato praktike/laboratorike. Ambientet e brendshme janë të pastra dhe të bollshme. Gjithashtu edhe ambientet përreth godinës ku zhvillohet aktiviteti didaktik janë çlodhëse dhe ndihmojnë në përmirësimin në tërësi të ambientit dhe frymës ku këto aktivitete zhvillohen.</p>

	<p><i>Shtojca 3.22 Infrastruktura Lab. në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.7.1 Raport i vlerësimit të brendshëm 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ne përgjithësi sallat e përcaktuara për procesin e mësimor janë të pajisura me pajisjet më moderne që përfshijnë projektorët, tabela, kompjuterat në laboratorët kompjuterikë dhe instrumentet eksperimentale për laboratorin e fizikes, kimisë, dhe një bibliotekë e bollshme.</p> <p><i>Shtojca 3.22 Infrastruktura Lab. në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.7.1 Raport i vlerësimit të brendshëm 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët duke përfshirë edhe qasje në bibliotekë, përdorimin e laboreve në orare të zgjatura. Stafin akademik ka qasje në sistemin digjital të menaxhimit të brendshëm të të dhënave të studentëve për modulet lëndore që ata mbulojnë. Në këtë sistem stafi akademik vendos vlerësimet e studentëve të cilat më pas i shërbejnë studentit për të patur njohuri rreth avancimit të tij akademik por edhe sekretarisë mësimore për të përpunuar të dhënat në funksion të aktiviteteve të saj. Personeli akademik ka qasje edhe në platformat online të parashikuara si ndihmëse për zhvillimin e procesit mësimor dhe në veçanti atyre të zhvillimit të aktiviteteve didaktike online. Personeli akademik dhe studentët në përgjithësi ishin të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin me sukses të programit mësimor.</p> <p><i>Shtojca 1.6 – Manual i Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3</i></p> <p><i>Shtojca 3.45 Infrastruktura TI në Ndihmë të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në plan programet e lëndëve të këtij programi studimi, literatura e parashikuara si e detyrueshme gjendet në bibliotekën e institucionit. Literatura e përgatitur nga pedagogët e lëndëve në formë konspektesh u jepej studentëve nga vet pedagogët dhe një kopje ruhet në njësinë bazë. Edhe pse literatura e përdorur për këtë program studimi gjendet në institucion, ajo nuk është e azhornuar me botime të pesë viteve të fundit. Për lëndët e formimit bazë në kategorinë e lëndëve si matematika, fizika apo kimi, që përbëjnë thellimin e njohurive bazë për studentët e këtij programi studimi, argumentet e trajtuar janë në përputhje me ato që gjenden në literaturën e rekomanduar, edhe pse nuk është e pesë viteve të fundit.</p>

	<p><i>GVJ rekomandon që institucioni, për lëndët karakterizuese, të përditësojë literaturën e përdorur me edicionet e reja që trajtojnë edhe ndryshimet teknologjike më të fundit në këtë sektor.</i></p> <p><i>Shtojca 3.23 Të dhëna për Fondin e Librave në Funkcion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e nevojshme për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor është e disponueshme në formë libri në bibliotekën e Fakulteti të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Në fillim të çdo semestri të gjithë lektorëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme, ju kërkohet të përcaktojnë literaturën që planifikojnë të përdorin në aktivitetin didaktik. Kërkesat e tyre paraqiten në Departament dhe shërbejnë si kërkesa për pasurimin e fondit të bibliotekës. Studentët gjithashtu kanë qasje edhe në formën software të materialeve të siguruara nga personeli akademik në platformën online të institucionit dhe ato të ofruara nga vet pedagogët në formë dispense apo shënime të lëndës.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave në dispozicion.</i></p> <p><i>Shtojca 3.23 Të dhëna për Fondin e Librave në Funkcion të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje qasjeje në bibliotekën digjitale “U-library” të ofruar në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin e cila garanton qasje në databazën EBSCO. Institucioni garanton qasje edhe në librarinë digjitale JSTOR (www.jstor.org) e cila përfshin literaturë në funksion të njohurive të përçuar në këtë program studimi. Studentët mund të përdorin libraritë digjitale edhe nga ambientet e bibliotekës e cila është e pajisur me kompjutera të lidhur në internet.</p> <p><i>Shtojca 3.23 Të dhëna për Fondin e Librave në Funkcion të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka disa laboratorë në funksion jo vetëm të këtij programi studimi por edhe të programeve të tjera të ofruara në këtë njësi kryesore. GVJ vizitoi laboratorin e fizikës, të kimisë dhe të informatikës. Laboratori i fizikës, me hapësirë të bollshme për të garantuar një klasë të marrë pjesë lehtësisht në një seancë laborator, ishte i pajisur me makete laboratorike të mjaftueshme në numër dhe në cilësi për të garantuar përçimin</p>

	<p>e dijeve të lëndëve të fizikës për këtë program studim. Në mënyrë ekuivalente edhe laborator i kimisë ishte i pajisur me maketet përkatëse të cilat u shpjeguan nga pedagogu përgjegjës. Laboratori i Informatikës i pajisur me 20 kompjuter të tipit Desktop me kapacitete teknike (Memorie, Procesor, kujtesë ruajtëse etj.) ishin të viteve të fundit të siguruara nga institucioni falë projekteve të realizuara me ente të jashtme dhe jo me fonde të institucionit. Laboratori i dytë i informatikës, i ngjashëm në përbërje me laboratorin e parë, përbëhet nga 24 kompjuter Desktop. Në secilin nga kompjuterat janë instaluar software e nevojshëm për zhvillimin e duhur të orëve laboratorike, ushtrimeve etj. Programet e instaluar janë nga ato të editimit të tekstit si Microsoft Office dhe deri tek ato për përdorim më profesional si Visual Studio, Android Studio, Eclipse, Dev++, Xampp, Neatbeans, SWI-Prolog, NetSim Network Simulator, Cisco Packet Tracer etj. Gjithashtu, në laborator ishte e vendosur edhe një tabelë interaktive digjitale në funksion të metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Shtojca 3.22 Infrastruktura Lab. në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.45 Infrastruktura TI në Ndihmë të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni, dhe në veçanti pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë përdorur platforma online për pjesë të ndryshme të aktiviteteve didaktike. Veprimtari që janë rritur në dy vjeçarim e fundit edhe të motivuar nga situata e krijuar prej pandemisë Sars-Cov-2 (Covid-19). Për këtë qëllim, pedagogët e njësisë bazë, Departamenti i Informatikës, jo vetëm kanë përdorur platforma online si Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams, Esse3 etj., por kanë hartuar edhe manuale përdorimi për tu përdorur edhe nga koleg të të gjithë institucionit në tërësi. Bazuar edhe në anketimet e realizuara nga pedagog të këtij fakulteti, përdorimi i platformave online të mësimdhënies janë mirëpritur nga studentët dhe gjykohej që të mund të përdoren me efikasitet përtej kushteve të diktuar nga situata e pandemisë globale.</p> <p><i>Shtojca 4.9 Manual Moodle</i></p> <p><i>Shtojca 4.10 Manual EduMeet</i></p> <p><i>Shtojca 3.5 Plani i Veprimit në për Zbatimin e Office 365</i></p> <p><i>Shtojca 4.11 Prezantimi i Studimit për Mësimin Online RAEM 2021</i></p>

<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Institucioni ka në përdorim sistemin ESSE3 që prej muajit mars 2016 të ofruar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) ku në të studentët, pedagogët, sekretaria mësimore kanë qasje të kushtëzuar në vartësi të rolit që kanë në institucion (student, pedagog, personel administrativ etj.). Studenti ka qasje vetëm në të dhënat personale apo ato që lidhen me të (nota, të dhëna financiare etj.), Pedagogu ka qasje vetëm në listën e studentëve dhe notat e vendosura në lëndën për të cilën është angazhuar në mësimdhënie, sekretaria mësimore ka qasje në të dhënat e studentit në funksion të aktivitetit normal të saj. Të gjitha këto të dhëna përpunohen nga institucioni në përputhje me rregulloren për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale. Përveç sistemit ESSE3, në institucion përdoret edhe sistemi Moodle ku studentët dhe pedagogët kanë qasje po me të njëjtat kredenciale që përdorin edhe për sistemin ESSE3 duke mbajtur të njëjtin nivel qasjeje dhe privatësie në përdorimin e tij.</p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE3,</i> <i>Shtojca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i> <i>Shtojca 1.9 Rregullore e Ruajtjes së të Dhënave</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Përmbyllja e studimeve realizohet me provim formimi ose me mbrojtje të punimit të diplomës për studentët me mesatare mbi 7. Në fillim të vitit të tretë akademik, studentet që kanë të drejtë të mbrojnë diplomë me punim diplome përzgjedhin nga temat e ofruara nga pedagogët e institucionit. Temat e propozuara nga pedagogët e institucionit janë të miratuara paraprakisht në njësinë bazë. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik (udhëheqësi i punimit të diplomës) janë në kontakte periodike (të paktën tre kontrole të ndërmjetme) gjatë gjithë semestrit, deri në përfundimin e punimit të diplomës.</p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI 2020-2023</i> <i>Shtojca 2.14 Manual për Punimin e Diplomës</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

	<p>të përmirësimit të cilësisë bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e hartuara në nivel raporti nga njësitë përgjegjëse (NJSBC). Mirëfunksionimi i koordinimit midis NJSBC-së dhe njësisë bazë si njësi zbatuese është e shprehur qartë edhe në planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore dhe asaj të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.</p> <p><i>Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë bazë</i> <i>Shtojca 3.2 Vendim i Rektoratit NR.1</i> <i>Shtojca 3.7.1, 3.7.2 UNIKO Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Shtojca 2.4.2 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies nga personeli akademik me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe përshtatjen me zhvillimet teknologjike në fushë. Kjo është treguar më mbështetjen nga IAL të departamentit dhe personelit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime të ndryshme dhe bashkëpunimin me universitete të huaja. Megjithatë vihet re se institucioni përveç objektivave për rritjen e mbështetjes së stafit akademik për rritjen e tyre akademike dhe shkencore, ofron një mbështetje të ulët financiare për arritjen e objektivave.</p> <p><i>Shtojca 3.39 Didaktika e Shkencave</i> <i>Shtojcat 3.31 Workshop-Konferencat RAEM</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Informatikës, edhe pse ka një përbërje staf akademik në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë, një pjesë e stafit akademik janë me kualifikimin “Master i Shkencave” dhe janë në proces të zhvillimit të shkollës doktoare. Stafit akademik, edhe pse me kualifikimin “Msc”, ka një përvojë të gjatë në mësim dhënie pranë këtij institucioni. Megjithatë vërehet një mbështetje e ulët e institucionit në promovimin e stafit për tu kualifikuar më tej në fushën e tyre të ekspertizës. Stafit akademik është angazhuar me mbështetje personale të marrë pjesë në aktivitete shkencore.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionin të mbështes më shumë stafin akademik për të rritur kualifikimet jo vetëm në mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca apo botime në</i></p>

	<p><i>revista por edhe në uljen e ngarkesës akademike për stafin që është në proces doktorate për ta përmbyllur atë.</i></p> <p><i>Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e Stafit Akademik</i></p> <p><i>Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njesisë Bazë</i></p> <p><i>Shtojca 3.29 Aktivitete Shkencore DI,</i></p> <p><i>Shtojca 3.30 Aktivitet Korça Global Digital City,</i></p> <p><i>Shtojca 3.31.1, 3.31.2 RAEM 2018, RAEM 2019</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni bazuar në sektorin e ngritur në nivel IAL (SKVIA) promovon trajnime brenda institucionit për rritjen e njohurive të stafit akademik për përdorimin kryesisht të metodave të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. Këto trajnime organizohen në nivel institucioni nga staf akademik i njesisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Megjithatë, në nivel institucioni nuk vërehet një angazhim domethënës në rritjen dhe kualifikimin e personelit akademik. Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka realizuar herë pas here aktivitete didaktike me pedagog të ftuar në formën e orëve të hapura të cilat shërbejnë si një aktivitet shkëmbim eksperiencash.</p> <p><i>Shtojca 3.42 Trajnimet e Stafit Akademik DI</i></p> <p><i>Shtojca 3.18 Shembulli i orëve të hapura</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i institucionit dhe personeli ndihmës akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin caktimin e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota.</p> <p><i>Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e Stafit të Përfshirë në Programin e Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Kryesisht metodat e përdorura nga ana institucionit ishin tradicionale, por po bëheshin përpjeke që krahas tyre të futeshin edhe metodat bashkëkohore duke vendosur studentin në qendër të mësimdhënies. Synohet që mësimdhënia të orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar</p>

	mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë reale të jetës. <i>Shtojca 3.8 Analizë Vjetore e Veprimtarisë së Departamentit të Informatikë</i> <i>Shtojca 2.29 Analiza Vjetore FSHNH</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe në atë të programit të studimit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërës informimit të studentit nga pedagogët e lëndëve në javën e parë të zhvillimit të aktivitetit didaktik për çdo lëndë. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i aksesojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi; - 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit); - 10 % testimet gjatë vitit; - 60-70 % provimi përfundimtar; <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njesisë Kryesore</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i> <i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit deri në njësinë bazë si dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të</p>

<p>e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentet, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës.</p> <p><i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e Esse3</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar rregulloreve të institucionit, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj.), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Është kompetencë e pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit. Për këtë studentët janë në dijeni paraprakisht.</p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p> <p><i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p> <p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve të studentëve, konform rregulloreve institucionale, të njësisë kryesore dhe asaj bazë, bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	<p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. në përgjithësi realizohet një kontroll i ndërmjetëm dhe një përfundimtar. Studentët testohen me teste, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës. Për këto vlerësime gjatë semestri, studenti vihet në dijeni nga pedagogu përkatës por njëkohësisht, këto të dhëna shfaqen në faqen personale të studentit në sistemin ESSE3.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njesisë Kryesore</i></p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p> <p><i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimi dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, institucioni ka në përdorim disa platforma elektronike (Microsoft Teams, dhe Office 365) të cilat lejojnë ndërtimin e pyetësorëve apo testime në format quiz-i (me alternativa) dhe e kombinuar dhe me pyetje të natyrës teorike, të cilat korrigjohen nga pedagogu i lëndës. Në këto raste, të pyetjeve me alternativa ku është përcaktuar paraprakisht nga pedagogu se cila është alternativa e saktë, me mbylljen e quiz-it nga studenti, automatikisht gjenerohet edhe vlerësimi i tij bazuar mbi përgjigjet e ofruara. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Notat hidhen në mënyrë elektronike në Sistemin Interaktiv ESSE3.</p> <p><i>Shtojca 2.18 Manual Mësimi Online Training in Microsoft Teams 365</i></p> <p><i>Shtojca 3.42 Trajnimet e Stafit Akademik DI</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar për lëndët apo modulet realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga njësia bazë dhe të miratuara nga Dekani i njesisë kryesore përkatëse konform rregulloreve institucionale. Vlerësimi i punimit të diplomës realizohet nga një komision me jo më pak se tre anëtar të njesisë bazë përgjegjëse e cila bazohet jo vetëm në punimin e studentit por edhe në vlerësimin e pedagogut udhëheqës.</p> <p><i>Shtojca 1.2-Rregullore e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.2 - Rregullore e Brendshme e Njesisë Kryesore</i></p> <p><i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i></p> <p><i>Shtojca 3.38 Model Vlerësimi Oponent/Udhëheqës (drejtues) Temë Diplome</i></p>

<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar në rregulloret institucionale, provimet zhvillohen me sekretim nga sekretaria mësimore. Në provim studenti paraqitet me një fletore standarde të miratuar për provim nga institucioni e cila paraqet logon e Universitetit të Korçës Fan S. Noli, dhe e parashikuar në një pjesë ku studenti të plotësojë gjeneralitetet e tij. Në përfundim të provimit, sekretari mësimor mbledh fletoret e plotësuar tashmë nga studentët dhe me zgjidhjet përkatëse, dhe pa praninë e pedagogut, gris në dysh kapakun ku janë shkruajtur gjeneralitetet e studentit duke i vendosur si në pjesën e gjeneraliteteve ashtu edhe në atë të fletores, të njëjtin numër rendor. Fletoren me numër rendor rastësor, pa gjeneralitetet e studentit, i dorëzohet pedagogut të lëndës për ti korrigjuar. Më pas vlerësimi i pedagogut bashkohet me emrin e studentit në sekretarinë mësimore dhe plotësohet procesverbali i vlerësimit.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i> <i>Shtojca 4.12 Model Provimi me Sekretim</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive behet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit,</p>

	<p>përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar dhe Kodit të Etikës.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e Njësisë Kryesore</i> <i>Shtojca 1.20 Kodi i Etikës UK</i> <i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi ESSE3, ose/dhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda tre ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit ESSE3. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament. Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e FSHNH</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo qartësoheshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në duke disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e FSHNH</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p>

<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale të cilat kanë të përcaktuara të gjitha hallkat dhe mënyrat se si dhe kur studenti të kryej një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete pasi studentët nuk kishin patur ankesa/kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e FSHNH</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit TI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike në fushën teknologjisë së informacionit si dhe përmbillet me punimin e diplomës. Megjithatë, vërehet mungesa e një lënde/moduli “Praktikë Profesionale” e cila do të ndihmonte studentin të vinte në praktikë njohuritë e përftuara në një ambient real në tregun e punës. Departamenti ofron shërbime shtese krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për thellimin e studimeve në ciklin master. Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike, të cilat sipas institucionit janë të përfshira në ngarkesën e ushtrimeve që zhvillohen në laboratorë por emërtimi në planin mësimor dhe programet e lëndëve është si “Ushtrime”.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionin të hartojë plan-programet (syllabuset e lëndëve) duke detajuar ndarjen e orëve në auditor dhe krediteteve përkatëse për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare/ushtrime, laboratorë, detyra/projekte kursi etj.)</i></p>

	<p><i>Shtojca 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit TI</i></p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të përgjithshëm si lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglisht), lëndë për aftësimin logjik (Llogjikë Formale/Aftësi Drejtimi), aftësi menaxhuese (Menaxhim i Projektit dhe Sistemet e Informacionit të Menaxhimit) etj.</p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 Plani mësimor i programit të studimit TI</i></p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.22 Infrastruktura Lab. në Funkcion të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në veçanti rregullores së programit të studimit dhe atyre institucionale, konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lënde, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.</p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 4.1 Tabelat Përmbledhëse për Aneks RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javet e fundit, pedagogët e lendes informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë këtij institucioni. Stafi i Departamentit të informatikës organizon diskutime me studentet për temat e</p>

<p>jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve.</p> <p><i>Shtojca 3.18 Shembulli i Orëve të Hapura</i> <i>Shtojca 3.29 Aktivitetet Shkencore DI 2021</i> <i>Shtojca 3.30 Aktivitet DI Korça Global Digital City 2020</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Institucioni garanton qasje në laboratorët e fizikës, kimisë dhe informatikës për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i ushtrimeve/seminareve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i laboratorëve për të gjitha lëndët e fizikës, kimisë, elektronikës dhe informatikës. Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seancave laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (seminare/ushtime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik.</p> <p><i>Shtojcat 2.8.1, 2.8.2, 2.8.3 Programet Lëndore të Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, labore etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës. Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e programit.</p> <p><i>Shtojca 3.18 Shembulli i Orëve të Hapura</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim studentët-pedagog. Aktivitetet kërkimore shkencore të zhvilluara nga stafi akademik i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është kryesisht i bazuar në punë individuale dhe pa mbështetje financiare apo logjistike të institucionit. Megjithatë, edhe në kushtet e një mbështetje shumë të dobët nga institucioni, stafi akademik ka marrë pjesë apo ka organizuara disa aktivitete shkencore në nivel lokal.</p> <p><i>Shtojca 3.29 Aktivitetet Shkencore DI 2021</i> <i>Shtojca 3.39.2 Konferenca RAEM 2019</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative,</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë, Departamenti i Informatikës, mbështet studentët për zhvillimin e ideve të tyre në</p>

studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	<p>ambientet e institucionit duke vënë në dispozicion të gjithë bazën laboratorike. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi u vu në dukje mbështetja dhe ndihma e stafit akademik për studentët në zhvillimin e projekteve.</p> <p>Megjithatë, nuk vihet re një mbështetje financiare e institucionit për rritjen e studimeve të avancuara kërkimore si për stafin ashtu edhe për studentët.</p> <p><i>Shtojca 3. 22 Infrastruktura e Lab. në Funksion të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Shtojca 3.29 Aktivitetet Shkencore DI 2021</i></p>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit vërehet se personeli akademik kombinon format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. Departamenti i Informatikës ka përdorur mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e Erasmus, që bëjnë të mundur vizita afatshkurtra të realizuara nga personeli akademik si dhe kanë ngritur një laborator të informatikës bazuar në këtë projekt.</p> <p><i>Shtojca 4.1 Tabelat Përmbledhëse për aneks RVB</i></p> <p><i>Shtojca 2.10 Marrëveshjet e Bashkëpunimit DI</i></p> <p><i>Shtojca 3.40 Projekti Erasmus+ TeComp</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore dhe ajo e njësisë bazë paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve gjenden në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni. Për studentët me mesatare mbi 7 ofrohet mundësia e zhvillimit të punimit të diplomës. Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për tematikat e zhvillimit të punimeve të diplomave, hartohen nga stafi i brendshëm akademik dhe vihen në dispozicion të studentëve. Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. Fondi i pyetjeve së bashku me udhëzuesin e punimit të diplomës janë në dispozicion të studentëve si në zyrën e informimit të studentit pranë njësisë kryesore dhe po ashtu u vihet në dispozicion në platformën elektronike Microsoft Teams.</p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i> <i>Shtojca 2.15 Pyetjet e Provimit të Formimit TI</i> <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësia bazë, Departamenti i Informatikës. Kjo njësi harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit. Fond pyetjesh që u vihen studentëve në dispozicion në zyrën e informimit pranë njësisë kryesore. Gjithashtu, për studentët që plotësojnë kriterin minimal të notës mesatare të ponderuar jo më pak se 7, u jepet mundësia e zhvillimit të punimit të diplomës në formë projekti. Edhe në këtë rast, studentëve u shpërndalet udhëzuesi për punimin e diplomës së bashku me temat e mundshme që studenti mund të zgjedhë për të zhvilluar.</p> <p><i>Shtojca 2.15 Pyetjet e Provimit të Formimit TI</i> <i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p>

	<p><i>Shtojca 2.30 Model Teze Provimi Formimi</i></p> <p><i>Shtojca 2.15 Pyetjet e Provimit të Formimit TI</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.</p> <p><i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i></p> <p><i>Shtojca 2.15 Pyetjet e Provimit të Formimit TI</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në udhëzuesin e punimit të diplomës, për këtë program studimi, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja përfshinë edhe vënien në dispozicion të studentit ambientet laboratorike nëse është e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, origjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><i>Shtojca 2.14 Udhëzues për Punimin e Diplomës TI</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Procedura e diplomimit për studentët e këtij institucioni është e hartuar qartë në rregulloret e ndryshme që janë hartuar në nivel institucioni, njësie kryesore dhe asaj bazë. Provimi përfundimtar ose projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi bëhet në bazë të vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidatit dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga komisioni. Nota komunikohet në prani të komisionit nga kryetari i komisionit .Ne rastin e provimit përfundimtar nota</p>

	<p>del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për fushën përkatëse</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.3 Rregullore e DI</i></p> <p><i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e Programit të Studimit TI</i></p> <p><i>Shtojca 3.17 Model i Procesverbalit të Diplomimit</i></p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma mbart elementët e përcaktuar dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe lëshohet vetëm njëherë nga institucioni. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar kur ai e kërkon këtë gjë.</p> <p><i>Shtojca 2.6 Suplementi BA Teknologji Informacioni</i></p> <p><i>Shtojca 2.6.1 Diploma Bachelor në Teknologji Informacioni</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material mund të jepet edhe në gjuhën angleze, fakt që ndihmon studentin kur shkon jashtë shtetit për studime ose punësim.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë.</p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullore e Brendshme e FSHNH</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Universiteti i Korçës, Fan S. Noli, mirë administron të dhënat e personelit akademik me kohë të plotë, të pjesshme, të stafit administrativ dhe ndihmës-mësimor përmes dy strukturave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtoria Juridike e Burimeve Njerëzore (DJBNJ); 2. Njësia Bazë/ Departamenti i Informatikës; <p>Veprimtaria e tyre zhvillohet bazuar në Udhëzimin nr. 99 datë 12.02.2020 për “Elementët e Dosjes së Stafit Akademik dhe Administrativ” i cili përcakton qartë në sesionin I elementët e dosjes së stafit akademik dhe administrativ. Universiteti “Fan S. Noli” (UK) ka ngritur Drejtorinë Juridike të Burimeve Njerëzore e cila në organikën e saj ka dy sektorë përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sektori Juridik dhe Arkiv – Protokollit; - Sektori i Informacionit dhe Promocionit <p>Në këto sektorë janë të angazhuar një staf prej 8 vetash. GVJ gjen një mospërputhje midis emërimit të kësaj drejtorie në organigramën e UK-së 2021 dhe emërimit të shprehur në rregulloren e saj: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit (DBNJKP) të cilën e konsiderojmë me vend edhe në përputhje me sektorët që ajo përmban të shprehur edhe më lart. DBNJKP zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me rregulloren të miratuar nga Senati Akademik në vendimin nr. 396 datë 22.07.2019. Neni 4 pika a, neni 5, neni 6 në këtë rregullore përcaktojnë qartë detyrat që Drejtori i DBNJKP është përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të personelit. GVJ ndërmoi edhe një takim me përfaqësues të DBNJKP, ku në mënyrë rastësore përzgjedhi dosjet e personelit akademik me kohe të plotë dhe të pjesshme dhe konstaton që dokumentacioni i administruar nga personeli në këtë drejtori është në përputhje edhe me përcaktimet e shprehur në nenin 6</p>

të rregullores së DBNJKP-së. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit është përgjegjësi i njësisë bazë. Njësia bazë mban të dhëna në lidhje me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në programin e studimit. Kjo njësi bën parashikimin e ngarkesës mësimore të secilit personel akademik, monitoron dhe raporton ngarkesën reale të realizuar në fund të vitit akademik. Njësia bazë është përgjegjëse edhe për administrimin e programeve lëndore (syllabuset) të secilit pedagog, leksionet, dispensat apo tekstet e miratuara, testet dhe fondet e pyetjeve për çdo lëndë/modul dhe dokumente të tjera të formimit akademik/ profesional (publikime, referime, pjesëmarrje në konferenca etj.) të cilat më pas përpunohen në fund të çdo viti akademik dhe reflektohen në raportin vjetor. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe takimeve të zhvilluara konstatojmë një korrektësi të zbatimit të procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi, si edhe në përputhje me VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, Rregullores së institucionit dhe Rregullores së Programit të Studimit.

Shtojca 1.1 Statuti I UK

Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli

Shtojca 1.4 Rregullorja e drejtorisë së burimeve njerëzore komunikimit dhe promocionit

Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit UK Shtojca 3.41 Model dokumenti për organizimin e kohës vjetore të punës 2020-2021

Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Institucioni harton dhe zbaton procedura punësimi me kohë të plote dhe të pjesshme bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Procedura e punësimit të personelit akademik është e shprehur qartë në dokumentet bazë institucionale. Neni 40 “Punësimi i Personelit Akademik” në Statut përcakton procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, ndërsa neni 32 në Rregulloren e UK-së shpreh edhe kriteret për rekrutimin e stafit në kategoritë “Profesor”, “Lektore ” dhe “Asistent – Lektore”. GVJ gjen një mospërputhje në lidhje me praktikën e punësimit të shprehur në Statut të UK dhe në draft-Statutin e ndryshuar të tij. Neni 40 në Statut të UK përcakton edhe përmbajtjen e komisionin adhoc si vijon më poshtë:

Adhoc: 5 anëtarë

- Përgjegjësi i njësisë bazë – 1 anëtar
- Personel akademik i fushës përkatëse i njësisë bazë - 2 anëtarë
- Z/Rektori i UK – 1 anëtar
- DBVNJ – Anëtar

Kjo përbërje është e shprehur edhe në nenin 86.

Në draft Statutin e ndryshuar GVJ konstaton një ndryshim në anëtarësinë e adhoc:

Adhoc: 5 anëtarë

- Rektori: 1 anëtar
- DVBNJ: 1 anëtar
- Njësia baze: 2 anëtarë
- **Anëtar i përcaktuar nga Dekanati – 1 anëtar**

Kjo e fundit i atribuon Dekanatit të ketë përfaqësimin e tij në adhoc të cilën nuk e gjejmë të shprehur në nenin 25 dhe 26 “Dekanati”, “Dekani i Fakultetit” në Statutin e ndryshuar ndërsa përcaktohet si detyre e Drejtuesit të Njesisë Bazë në nenin 28 të tij.

GVJ vlerëson se Draft-statuti i propozuar akoma nuk është miratuar dhe ka nevojë të rishikohet. Rekomandojmë që të bëhen rregullimet përkatëse ligjore në Statutin e ndryshuar cilat do të japin qartë edhe formimin e adhoc në punësimin e personelit akademik me kohë të plotë.

GVJ vëren në dokumente bazë ligjore procedurat dhe kriteret për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë ndërsa nuk gjejmë përcaktimet ligjore për punësimin e stafit akademik me kohe të pjesshme. Rekomandojmë që të bëhen plotësimet ligjore përkatëse në dokumentet bazë për këtë kategori personeli akademik. GVJ gjeti praktikën e ndjekur për punësimin e personelit akademik në përputhje me procedurën e shprehur në nenin 40 në Statut, neni 32 në Rregulloren e UK-së dhe në nenin 86 në Rregulloren e Njesisë Bazë.

Shtojca 1.1 Statuti I UK

Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli

Shtojca 1.13 Udhëzim rektorati për rekrutimin e stafit

Shtojca 1.2 rregullorja e UK

Shtojca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore

Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e DI

Shtojca 4.2 Shpallje konkursi për personel akademik

	<p><i>Shtojca 3 Format vendimi komisioni AD HOC</i></p> <p><i>Shtojca 4.5 Format urdhër emërimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni organizon procedura punësimi të stafit akademik në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar në Statut dhe në Rregulloren e UK-së në fuqi. Departamenti i Informatikës është përgjegjëse për hartimin e kriterëve të veçanta në punësimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në aktivitetet didaktike që mbulohen nga ky departament. GVJ konstaton që evidencat e dëshmuara nga institucioni janë dhënë vetëm për kategorinë “Asistent – Lektor” ndërsa mungojnë përcaktimet siç janë të shprehur edhe në nenin 32 të Rregullores së UK për kategorinë “Lektor” dhe “Profesor”. Në procedurën e paraqitur nga institucioni konstatojmë si kriter i veçantë mesataren që duhet të jetë mbi 8.5 ndërsa në kriteret e përgjithshme për këtë kategori mbetet eksperiencia mbi 1 vjeçare. Departamenti i Informatikës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane dhe Dekanati i tij përballen me vështirësinë e rekrutimit të një stafi të kualifikuar në fushën e informatikës si rrjedhojë e mungesës në zonën e Korçës të kandidatëve që zotërojnë grada dhe tituj akademik dhe janë të kualifikuar në këtë fushë. Për vitin 2020 në këtë departament është punësuar 1 personel akademik me kohe të plotë dhe me kualifikimin Master i Shkencave (Msc.). Këto të dhëna dëshmojnë numrin e pakët të personelit akademik me kohë të plotë dhe grada shkencore dhe punësimin e stafit në kategorinë “Asistent – Lektor” që është konsideruar edhe nga vete institucioni si pikë e dobët në Planin Strategjik të Zhvillimit për Programin e Studimit.</p> <p><i>Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë</i></p> <p><i>dokument shtesë 2: praktika e rritjes profesionale të stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për rekrutimin e stafit akademik janë të mirë përcaktuar në dokumentet bazë institucionale. Departamenti i Informatikës është përgjegjëse për vendosjen e kriterëve të veçanta ndërsa kriteret e përgjithshme janë të shprehur në Statut dhe në Rregulloren e UK-së. Procedurat e rekrutimit administrohen nga DVBNJ. Kërkesa për rekrutimin të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme buron nga njësia bazë. Në nenin 40 në Statut është përcaktuar që procedura e rekrutimit të jetë transparente, objektive, me konkurs të hapur. GVJ përmes takimeve të zhvilluara gjen një zbatim të drejte dhe korrekt të saj në përputhje të plotë me klauzolat ligjore të vendosura në dokumente bazë të institucionit. GVJ gjen me vend ndryshimet e bëra nga</p>

	Rektorati përmes vendimit nr.6 datë 17.12.2019 "Për Vlerësimin e Kandidatëve që punësohen si Personel Akademik" por nuk evidentojmë një praktike reale të zbatimit korrekt të saj në dokumentacionin e dhëne nga Institucioni <i>Shtojca 1.13 Udhëzim rektorati për rekrutimin e stafit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>UK paraqet përpjekje të qarta në lidhje me përmirësimin e mjediseve mësimore dhe infrastrukturës ndihmëse në funksion të punës së personelit akademik dhe në mbështetje të procesit mësimor. Institucioni garanton një infrastrukturë bashkëkohore për një zhvillim normal të punës mësimore – kërkimore dhe ka siguruar kushte të kënaqshme për studentët dhe stafin. Mjediset dhe infrastruktura është konsideruar në analizën SWOT të institucionit si një pikë e fortë e tij. Megjithatë, mbështetja institucionale për kërkimin shkencor dhe avancimin akademik të stafit është minimale.</p> <p><i>GJV sugjeron që institucioni të mbështesë më mirë kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte.</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p> <p><i>Shtojca 1.2 rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit të Informatikës</i></p> <p><i>Shtojca 1.3 Plani strategjik UNIKO 2016-2020</i></p> <p><i>Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni mbështet aftësimin profesional të personelit akademik me kohë të plotë. Duke konsideruar që numri i stafit akademik me grada shkencore në Departamentin e Informatikës është i ulët, një nxitje i jepet kategorisë 'Asistent – Lektor' për të mbaruar studimet në fushën e doktoratës. Ndonëse mbështetja financiare është e kufizuar, nga takimi me stafin akademik u theksua mbështetja që</p>

	<p>njësia bazë jep përmes lehtësimit në grafikun mësimor nëse kërkohet nga ana e stafit akademik. Kjo për të lehtësuar pjesëmarrje në konferenca shkencore apo për studime të thelluara për marrjen e gradës “Doktori i Shkencave”. Shembull u sollën nga stafi akademik gjatë takimit në institucion, ku pedagogët e rinj vlerësuan ndihmën e dhënë nga stafi me eksperiencë dhe mbështetjen dhe inkurajimin që Departamenti i Informatikës u ka dhënë në lidhje me rritjen e kualifikimeve shkencore. GVJ konstaton pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca dhe pasqyrimet e tyre në raportet vjetore. Mbetet akoma shumë për tu bërë në këtë drejtim ashtu siç shprehet edhe në rekomandimet e dhëna në këto raporte.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të garantojë një mbështetje më të madhe edhe financiare për promovimin dhe avancimin akademik dhe shkencor të stafit të kësaj njësie bazë.</i></p> <p><i>Shtojca 2.29 Analiza mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 (analiza vjetore FSHNH)</i></p> <p><i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës (analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë)</i></p> <p><i>Shtojca 3.42 Raport trajnimesh të stafit akademik të departamentit të informatikës</i></p> <p><i>dokumente shtese 2: praktika rritjes së kualifikimit të stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni në Strategjinë e tij të Zhvillimit 2021-2026 ka konsideruar gjithmonë përmirësimin e metodave inovative të mësimdhënies. Monitorimi i tyre është pjesë e pyetësorit që studentët plotësojnë në fund të çdo semestri akademik në çdo lëndë/ modul. Për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021 duke konsideruar edhe ndryshimet për shkak të situatës së pandemisë Sars-Cov-2 (Covid-19), janë bërë trajnime të personelit akademik në drejtim të metodave dhe mënyrave të mësimdhënies në platformat online. Manualet dhe trajnime janë bërë për platformat Moodle, eduMeet dhe Microsoft Teams 365. Ajo që vihet re, është se këto trajnime janë realizuar në nivel institucioni dhe kryesisht janë realizuar me ndihmën dhe mbështetjen e stafit akademik të njësisë bazë “Departamenti i Informatikës” si njësia më me përvojë në këtë fushë.</p> <p><i>Shtojca 2.18 Training in Microsoft Teams 365</i></p> <p><i>Shtojca 4.6 Manual i përdorimit të librarisë elektronike U-Library</i></p> <p><i>Shtojca 4.9 Manual mbi përdorimin e moodle nga mësuesi</i></p>

	<i>Shtojca 4.10 Manual mbi përdorimin e edumeet</i>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Takimet e zhvilluara, dokumentacioni i paraqitur janë tregues të një shfrytëzimi me efikasitet të kapacitetit njerëzor, të stafit akademik dhe të stafit ndihmës mësimor jo vetëm në këtë program studimi por edhe në programe të tjera studimi brenda institucionit ku stafi akademik i kësaj njësie bazë angazhohet. <i>Shënime nga vizita</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit “Teknologji Informacioni” zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Ky fakultet zhvillon aktivitetin e tij në një godinë me 3 kate me një sipërfaqe totale 2400 m ² në pronësi shtetërore por më përgjegjësi administrimi nga UK. Godina është historike e cila ka patur disa qëllime përdorimi në vite. Aktualisht, e rikonstruktuar në vitet e fundit, i është rikthyer përdorimit të parë si një objekt arsimor. Institucioni ka siguruar mjediset e duhura në përputhje me standardet e cilësisë për të garantuar zhvillimin normal të procesit mësimor. Në funksion të procesit mësimor Departamenti i Informatikës i cili është një njësi e re e krijuar me vendim të Senatit Akademik nr.335 datë 25.06.2019 për këtë program studimi disponon laboratorë, mjediset si salla leksioni dhe seminare të cilat plotësojnë kapacitetet për numrin e studentëve aktive. Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet pritëse sipas kuotave të deklaruara duke përgatitur edhe një raport që paraqitet në Drejtorinë e Rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në ministrinë përgjegjëse për arsimin. <i>Shtojca 1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe mjediset mësimore në vizitën dy ditore dhe konstaton që infrastruktura për këtë program studimi është në përputhje

me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

me standardet cilësore. Për këtë program studimi janë vënë në dispozicion 4 salla leksione me sipërfaqe totale 275m², 6 klasa për seminare 184 m². Në funksion të programit të studimit janë 2 laboratorë përkatësisht i Fizikes dhe Kimisë Analitike (84 m²) dhe 2 laboratore të informatikës (85m²) të pajisura për të siguruar konkretizimin e kuadrit teorik në praktikë. Për stafin akademik janë vënë në dispozicion 4 zyra për personelin akademik me sipërfaqe totale 148 m², 2 zyra për IT me sipërfaqe 7m². GVJ konstaton përmirësime të bëra nga viti akademik 2018-2019 në 2019-2020. GVJ evidenton një shpërndarje më të mirë të ambienteve brenda godinës në funksion të programit të studimit dhe krijimin e hapësirave për disa struktura mbështetëse siç është salla e internetit me sipërfaqe 60m², zyrë informacioni për studentët (6m²), mjedis për fotokopjime, librari (24m²) por konstaton mungesë të sallës për aktivitete promovuese, të mjedisit për aktivitete studentore, mjediseve shplohëse , rekreative, mjediseve sportive për të cilat rekomandojmë të konsiderohen nga institucioni në vijim të plotësimit të kushteve për një ambient ndërveprues studentor. Megjithatë, përreth godinës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, ambienti është me gjelbërim, pemë, hapësira shplohëse dhe i mirëmbajtur. Bazuar në sondazhet e kryera në fund të çdo semestri akademik, studentët janë përgjigjur pozitivisht kushteve të infrastrukturës dhe ambienteve mësimore.

- Auditorët, ndriçimi, mjetet mësimore, ngrohja janë vlerësuar nga 55% “mire”, 40% “shumë mire”;
- Mjediset e jashtme janë vlerësuar nga 60% “shumë mire”;
- Qasja në internet 55% është vlerësuar “mire” dhe 30% shumë mirë.

Duke konfirmuar edhe gjetjet e GVJ gjatë vizitës në institucion.

3.7.2 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të parë dhe të dytë universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO raporti i vlerësimit të brendshëm 2018-201)

Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e

Mbështetur në përmbajtjen e programit mësimor nga Departamenti i Informatikës janë vënë në dispozicion 2 laboratorë të informatikës, 1 laborator i fizikës dhe 1 laborator i Kimisë Analitike. Laboratori i Kimisë dhe Kimisë Analitike ka rreth 30 vende i pajisur me mjete dhe pajisjet e duhura për të garantuar zhyllimin praktik. Në

<p>kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>vizitën e bërë u tregua edhe interesimi i studentëve për orët laboratorike ku konkretizimi i teorisë me praktiken konsiderohej e nevojshme. GVJ konstaton që një pjesë e madhe e pajisjeve janë të vjetra me gjithë përpjekjet e stafit akademik për mirëmbajtjen e tyre të cilat nuk garantojnë edhe punën kërkimore sikurse edhe është theksuar nga institucioni. Në funksion të programit mësimor janë vënë edhe 2 laboratorë të fizikës me kapacitet 25 dhe 40 vende. Laboratorët janë të pajisur me video projektorë dhe me të gjithë pajisjet e duhura për zhvillimin e orës mësimore. Konstatohet që ndonëse disa pajisje të laboratorit II të Fizikës plotësojnë kërkesat praktike edhe për lëndën e Elektronikës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të bëhen përpjekje edhe për krijimin e një laboratorit të veçantë që do të mbulonte nevojat për orët laboratorike për lëndën “Elektronikë” dhe “Elektroteknikë” të cilat janë pjesë e programit mësimor.</i></p> <p><i>Shtojca 3.16 Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit të ciklit të parë “Teknologji Informacioni” laboratorit i kimisë dhe kimisë analitike (laboratori i kimisë)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për programin mësimor “Teknologji Informacioni” janë 2 laboratorë të informatikës, të krijuar rishtas, të pajisur me kompjutera, video projektor dhe pajisje të tjera të nevojshme, lidhje internet me fibër optike (100Mbs). Të gjithë kompjuterat janë të lidhur në rrjet dhe kanë një qasje të vazhdueshëm të internetit dhe janë të pajisur me të gjithë programet e nevojshme në funksion të këtij programi studimi. Laboratori 1 zotëron 20 poste ndërsa laboratorit II ka 24 poste. Në shërbim të orëve laboratorike janë në angazhim edhe staf akademik ndihmës –mësimor. Programet e instaluar janë në versionet e tyre të fundit (2018-2020) (Microsoft Windows 10 Pro, Microsoft Visual Studio 2017, Dev-C++, Matlab, SPSS, Xampp, Eclipse 4, Netbeans 12, SWI-Prolog 8.2.4, Android Studio 4, NS3 Network Stimulator, SQL Server, Oracle, PSPICE-FOR-TI, Netsim Network Simulator) duke përbushur edhe objektivat e lëndëve. Në laboratorin II të informatikës GVJ konstatoi edhe pajisje shtesë mbështetëse ku vlen të përmendet skaner profesional, printer – skaner, video projektor i lëvizshëm përveç video projektor statik, webkamera (2 copë). Laboratori është në dispozicion të studentëve edhe jashtë orarit mësimor.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” nuk zhvillohet praktikë profesionale, ndonëse kërkesa për të u paraqit gjatë takimit me studentët.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë, që në rishikimin e planit mësimor, të parashikojë një lëndë/modul të veçantë për praktikën mësimore pranë institucioneve që UK ka marrëveshje apo parashikon të realizojë marrëveshje bashkëpunimi.</i></p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p> <p><i>Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB</i></p> <p><i>Shtojcat 2.7.1, 2.7.2 dhe 2.7.3 plani mësimor i programit të studimit TI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UK ka disa biblioteka të shpërndara në njësitë kryesore përbërëse. Biblioteka në FSHNH ofron një shërbim falas për studentët dhe stafin akademik. Fondi i saj rezulton në 10952 libra dhe revista ku 1544 ofron në gjuhë të huaj dhe 9048 libra në gjuhën shqipe. Biblioteka ka një sallë leximi e pajisur me kompjutera, qasje në internet. Kushtet e leximit dhe të studimit janë të kënaqshme, e ndriçuar mirë dhe e pajisur me sistem ngrohje. Literatura që ofrohet në këtë bibliotekë është e madhe dhe përditësimi me fonde të reja librash bëhen në çdo vit akademik bazuar edhe në kërkesat që burojnë nga stafi akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të</p>	<p>Për programin mësimor “Teknologji Informacioni” kërkesa për libra, tekste dhe literaturë shtesë mbulohet nga biblioteka e vendosur në FSHNH me një sipërfaqe 60m². Biblioteka ka një fond prej 10592 libra e revista, 1031 tituj. 1544 libra dhe revista ofrohen në gjuhë të huaj. Konkretisht nga evidencat dhe vizita në institucion GVJ konstaton fondin si vijon: 41 libra në fushën e matematikës (gjuha shqipe) dhe 14 në gjuhën angleze, 42 libra në fushën e</p>

<p>gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>fizikës në gjuhën shqipe dhe 13 në gjuhën angleze, 23 në fushën e informatikës dhe elektronikës dhe 45 në gjuhën angleze. Për sigurimin e literaturës bazë të nevojshme bashkëpunime kryhen me Universitetin Politeknik të Tiranës ku shfrytëzohen një pjesë e botimeve të personelit akademik të tij në këtë fushë. Në raportet vjetore të Departamenti të Informatikës është theksuar puna serioze që bëhen në lidhje me përgatitjen e dispensave si literaturë bazë nga ana e stafit akademik. Këta të fundit punojnë intesivisht në përkthimin e literaturës bashkëkohore duke konsideruar mungesën e fondit të librave në gjuhën shqipe në këtë fushë. Shërbimi i bibliotekës është në fokus edhe të pyetësorit të studentëve. Për vitin 2020-2021, në sondazhet e kryera, 30% e studentëve kanë vlerësuar që materialet janë të disponueshme kundrejt 30% që e kanë vlerësuar ‘pak’ dhe 5% ‘aspak’ ndërsa pyetjes ‘sa ju ndihmon literatura në biblioteka për detyrat tuaja’ është konsideruar nga 15% e studentëve ‘plotësisht’, 45% ‘pak’ dhe 10% ‘aspak’</p> <p><i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës (analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë)</i></p> <p><i>Shtojca 2.29 Analiza mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 (analiza vjetore FSHNH)</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në bashkëpunim me institucionet kombëtare ofron :</p> <ul style="list-style-type: none"> – Bibliotekën digjitale “U-LIBRARY” e ofruar nga ministria përgjegjëse për arsimin për të gjithë universitetet publike. Përmes qasjes në këtë shërbim ofrohet një fond elektronik prej 170,000 libra, 70 mln artikuj akademike; – Bibliotekën digjitale JSTOR (https://www.jstor.org) lehtësisht e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik;
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pajisur me kompjutera, internet dhe me një sistem ngrohje që ofron mundësi studimi studentëve, si edhe fotokopje të materialeve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e</p>	<p>Ndonëse pasurimi i bibliotekës ka qenë në qendër të strategjisë së institucionit në plotësimin e kërkesave të studentëve, GVJ nuk gjeti evidencë të qartë në lidhje me një plan të detajuar për pasurimin e zërave të bibliotekës.</p>

fondit ekzistues në mbështetje të programit.				
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur nga dita e Hënë – e Premte, ora 08:00 -20.00 dhe është në funksion të studentëve, pedagogëve dhe stafit akademik të FSHNH, <i>Shënime në vizitë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UK ka instaluar përmes marrëveshjes me RASH platformën elektronike ESSE 3 e cila është aktive dhe ofron një spektër të gjerë shërbimi dhe informacioni për studentët, sekretarinë mësimore dhe stafin akademik. Në takimin e zhvilluar në institucion, GVJ konstaton aktivizimin e këtij sistemi dhe përdorimin lehtësisht të tij nga ana e studentëve dhe stafit akademik. Manuali i përdorimit të ESSE3 është vënë në dispozicion të stafit akademik dhe është publikuar në faqen web të institucionit. Në UK është edhe zyra e IT e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen e tij. <i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka në përdorim sistemin e menaxhimit ESSE 3: Sistemi ESSE3 mundëson administrimin e informacionit për studentin që në momentin e regjistrimit të tij deri në fund të procesit të diplomimit. Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve në tre regjistrat bazë të cilët plotësohen me shkrim dhe mbahen në formë elektronike. Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron të dhënat e stafit akademik dhe dosjet personale të tyre në formë elektronike dhe në <i>hard copy</i> . Njësia bazë është përgjegjëse për administrimin e leksioneve,

	<p>syllabuseve, përmbajtjes së programeve mësimore, ngarkesës mësimore të parashikuar në fillim të vitit akademik dhe ngarkesës faktike të realizuar në fund të vitit, dosjet me arritjet akademike të stafit akademik etj. udhëzimet dhe ndryshimeve përkatës të ardhur nga MASR, të cilat administrohen edhe në formë elektronike.</p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p> <p><i>Shtojca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi ESSE3 ofron një shërbim të dedikuar për studentët, stafin akademik dhe sekretarinë mësimore. Institucioni ka garantuar edhe trajnimin në lidhje me përdorimin e tij dhe manuali i përdorimit të tij është vënë në dispozicion të grupeve të interesit që përdorin këtë sistem</p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p> <p><i>Shtojca 1.6.1 Marrëveshje RASH për ESSE3</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Situata e krijuar nga Covid-19 ka mundësuar zhvillimin e mësimdhënies online. Në lidhje me këtë institucioni ka udhëzuar dhe trajnuar stafin akademik përmes manualit të përdorimit të përdorë për mësimdhënie platformën elektronike Microsoft Teams, aplikacionin eduMEET për konferenca.</p> <p><i>2.18 Training in Microsoft Teams 365</i></p> <p><i>Shtojca 4.9 Manual mbi përdorimin e moodle nga mësuesi</i></p> <p><i>Shtojca 4.10 Manual mbi përdorimin e edumeeet</i></p> <p><i>Shtojca 4.11 Prezantimi i studimit për mësimin online RAEM 2021</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi ESSE 3 garanton një përgjigje në kohë reale të aktivitetit akademik. Sistemi mundëson përpunime statistikore në lidhje me studentin, progresin dhe detyrimet që ai mbart. Këto të dhëna përpunohen nga stafi administrativ (sekretaria mësimore) e cila ka qasje në këto të dhëna për mirë funksionimin e aktivitetit të saj. Studentët dhe stafi akademik kanë qasje në të dhëna të kufizuara në funksion të aktivitetit të tyre në institucion.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën</p>	<p>Informacioni bazë dhe ndihmës për universitetin, programet mësimore që ofrohen, kuadri ligjor, stafi akademik, oraret mësimore, regjistrimet, tarifat, projektet kërkimore shkencore, bursat, njoftimet dhe aktivitet sociale janë të reflektuar në faqen web: https://moodle.unkorce.rash.al/</p>

dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Struktura Administrative e UK-së i referohet ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dh Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Struktura administrative e UK përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> – <i>Bordi i Administrimit;</i> – <i>Administratori;</i> – <i>Drejtoria Ekonomike;</i> – <i>Drejtoria e Financës;</i> – <i>Spektori i Prokurimeve dhe Investimeve;</i> – <i>Spektori i Menaxhimit të Buxhetit dhe të Ardhurave;</i> – <i>Spektori i Shërbimeve;</i> – <i>Spektori i Shërbimeve Financiare;</i> – <i>Njësia e Auditimit të Brendshëm;</i> <p>Të drejtat dhe detyrat përcaktohen qartë në kreun IV në Statutin e UK-së. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë ku 1 anëtar është përfaqësues i zgjedhur nga studentet</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti I UK</i> <i>Shtojca 1.11 Rregullore e senatit akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe</p>	<p>Kreu X në Statutin e institucionit, përcakton qartë format e financimit dhe marrëdhëniet administrative dhe financiare që kryhen në UK. Financimi behet në përputhje me ligjin nr.80/2015 dhe akteve të tjera nënligjore. Autonomia financiare është në qendër të veprimtarisë në institucion. UK kryen aktivitetin e saj financiar mbi bazën e një plan buxheti</p>

teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

afatmesëm i cili ndërtohet mbi bazën e strategjisë së zhvillimit që ka institucioni. Të ardhurat janë nga fondet publike dhe të ardhurat që krijohen nga institucioni. Përdorimi i fondeve publike nga UK bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Burimet e financimit janë:

- Buxheti i shtetit;
- Pagesat e studentëve për arsimin;
- Të ardhurat për shërbimet e kryera;
- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
- Donacionet;
- Veprimtari kërkimore – shkencore;

UK ka hartuar edhe rregulloret financiare që përcaktojnë qartë mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga buxheti i shtetit. Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit është përcaktuar edhe në nenin 90 në Statut. Në grantin e mësimdhënies përfshihet edhe fondi i mbështetjes financiare i cili përfshin tre kategori financimi:

1. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;
2. Bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë;
3. Bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;

GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe mendimin e stafit akademik dhe përgjegjësi i departamentit dhe përfaqësues të Dekanantit për hartimin e buxhetit. Projekt buxheti hartohet në nivel institucioni për çdo njësi bazë në fakultet paraqet edhe propozimet brenda datës 20 Qershor dhe dekanatet paraqesin propozimet përmbledhëse deri në datën 30 Qershor. Administratori është përgjegjës për hartimin e projekt buxhetit vjetor mbi bazën e propozimeve të bëra dhe i paraqitet Senatit Akademik për miratim nga Rektorati dhe vijon më pas me miratimin nga Bordi i Administrimit. GVJ konstaton që raporti i veprimtarisë financiare i paraqitur nga Institucioni është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe përfshin të gjithë elementet që duhet të përmbajë një plan financiar por i përket vitit financiar 2018-2019 dhe nuk ka të dhëna në lidhje me dy vitet e tjera financiare. Zëri i studentëve është dhënë "tek transferta për individët" i cili për vitin 2018-2019 ka zënë edhe 5.69% të shpenzimeve korrente vjetore

dhe është realizuar në masën 86.59% të fondit të akorduar. Ky fond është përdorur për bursat e studentëve (2017-2018) si edhe për periudhën Janar 2018 – Qershor 2018 për studentët e vitit të dytë dhe të tretë. Të dhënat janë në nivel universiteti dhe GVJ nuk ka të dhëna financiare në lidhje me përfitimet në bursa për studentët në këtë program studimi. Për vitin 2018 janë realizuar investime në rikonstruksion godine e ish-shkollës mekanike, bibliotekën kërkimore, blerje kompjutera dhe mjete audiovizuale dhe pajisje teknike. Të ardhurat e arkëtuara më kryesore janë:

- Tarifat e shkollimit;
- Tarifat e regjistrimit;

Kostoja për student (nga buxheti i shtetit) ka pësuar një rritje nga viti 2017 – 2020. Për këtë periudhë varion:

- 2016-2017 : 60,480.09 Lekë/student;
- 2017-2018 : 64,705.73 Lekë/student;
- 2018-2019 : 86,06.65 Lekë/student;
- 2019-2020 : 114,877.12 Lekë/student;

Fondet e buxhetit të shtetit janë rritur në këtë periudhë akademike:

- 2016-2017 : 287,318,427 Lekë;
- 2017-2018 : 305,799,278 Lekë;
- 2018-2019 : 391,653,665 Lekë;
- 2019-2020 : 416,889,085 Lekë;

Numri i studentëve ka pësuar një rënie në këtë periudhë financiare:

- 2016-2017 : 4,750 studentë;
- 2017-2018 : 4,726 studentë;
- 2018-2019 : 4,549 studentë;
- 2019-2020 : 3,629 studentë ;

Shtojca 1.1 Statuti I UK

Shtojca 1.7 Rregullore e drejtorisë ekonomike

Shtojca 1.8 Rregullore e drejtorisë financiare (EDE)

Shtojca 1.8.1 Rregullorja financiare

Shtojca 1.21 Rregullore e bordit të administrimit

Shtojca 2.34 Kosto për student grant i buxhetit të shtetit (kosto për student 2017, 2018, 2019, 2020)

	<p><i>Shtojca 2.35 Fondet e universitetit grant i buxhetit & të ardhurat e krijuara, si dhe realizimi faktik për periudhën 2017, 2018, 2019, 2020 (fondet e universitetit 2017, 2018, 2019, 2020)</i></p> <p><i>Shtojca 3.15.1 Raporti financiar për kostot e programit të studimit (raporti financiar për kostot e programeve të studimit 2018-2019)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UK i nënshtrohet një sistem auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i brendshëm kryhet nga Njësia e Auditimit që ndodhet në varësi të Bordit të Administrimit. UK i nënshtrohet edhe auditimit nga Buxheti i Shtetit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit</p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli studimi UK dokumenton edhe raportet financiare të tre viteve të fundit dhe bën planifikimet për ndërhyrje të posaçme bazuar edhe në strategjinë afatmesëm të saj.</p> <p><i>Shtojca 3.15.1 Raporti financiar për kostot e programit të studimit (raporti financiar për kostot e programeve të studimit 2018-2019)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij program studimi ndonëse në raportet financiare nuk jepet qartë pesha financiare e këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Teknologji Informacioni” është ndërtuar referuar kornizës së nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e organizuar në 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale në tre vite akademike. UK ka institucionalizuar të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në programin Bachelor “Teknologji Informacioni”. Këto procedura janë të shprehur qartë në Statut të UK-së në Rregulloren e UK-së, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, në Rregulloren e Departamentit të Informatikës, në Rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë “Teknologji Informacioni” (2018-2021, 2019-2022, 2020-2023) të cilët përshkruajnë procesin e regjistrimit të studentëve, të zhvillimit të procesit mësimor, të transferimit, procedurën e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019</p> <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore</i></p> <p><i>Shtojca 2.3 Rregullore e brendshme e Departamentit të Informatikës</i></p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë “Teknologji Informacioni”</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Veprimtaria mësimore në programin “Teknologji Informacioni” zhvillohet në Departamentin e Informatikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është e kontrolluar dhe monitoruar nga strukturat kolegjiale dhe akademike në nivel institucioni dhe e mbështetur nga strukturat ndihmës-akademike dhe administrative. GVJ konstaton zbatimin me rigorozitet të procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos çenuar aspak lirinë përkatëse të tyre. Mbështetja për diferencime individuale</p>

	është përjashtim që lejohet nga organet kompetente sipas mënyrës së përcaktuar në ligj apo në akte nënligjore në fuqi.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ evidenton që kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të pasqyruara në dokumentet bazë institucionale. Në takimet e zhvilluar në institucion u theksua njohja nga ana e studenteve të procesit mësimor, të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Sensibilizimi bëhet edhe përmes broshurave dhe website, ku për këtë të fundit theksojmë publikimin e syllabuseve pjesë përbërëse e programit. <i>Shtojca 2.32 Udhërrëfyese i studentëve 2020-2021</i>
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Departamenti i Informatikës propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor miratimi i të cilës bëhet nga Senati Akademik dhe vijon me MASR <i>Shtojca 3.9 Për miratimin e kritereve të pranimit të studenteve në ciklin e parë të studimit për vitin akademik 2022-2023</i>
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe specifike janë të pasqyruar në Rregulloren e Programit të Studimit. GVJ konstaton që kriteret e pranimit të studentëve nuk kanë ndryshuar për periudhën 2018-2021. Për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të parë "Teknologji Informacioni" ka të drejtë të kandidojë çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore dhe përmbush kriteret minimale ligjore të miratuara çdo vit nga ministria përgjegjëse për arsimin. Këtë program mund ta ndjekin edhe studentë të huaj bazuar në marrëveshjet shumëpalëshe, shtetas të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (si program i dytë) kundrejt tarifës së caktuar. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton, me udhëzim, kriteret, kuotat dhe procedurat e pranimit ndërsa FSHNH në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës i zbaton ato. Kuadri ligjor mbi të cilën kryhet kjo procedure janë: Ligji Nr.80/2015, Udhëzimi nr.41 date 24.01.2018, pika 2.7, VKM nr.418 date 10.05.2017, VKM nr. 295 datë 10.05.2019. Për periudhën 2018-2021 nota mesatare për pranim në këtë program studimi luhetet në 6.5. <i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë "Teknologji Informacioni"</i>
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të	Departamenti i Informatikës zhvillon procese informimi në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor. Informimet bëhen në fillim të çdo semestri akademik. Gjithashtu,

<p>interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>institucioni në tërësi, por edhe stafi akademik i departamentit të Informatikës, marrin iniciativa informuese në shkollat e mesme të rrethit të Korçës për të informuar kandidatët e mundshëm rreth mundësive dhe programeve që Universiteti i Korçës, Fan S. Noli ofron. Stafi akademik në fillim të lëndës jep sqarime për përmbajtjen e saj, shpërndan syllabusin. Programi mësimor është i pasqyruar edhe në website të institucionin në rubrikën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 3 vite akademike. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Në këtë program studimi nuk ofrohet praktike profesionale. Organizimi i studimeve përcaktohet në Kreun VI në Statut ndërsa të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë të përcaktuar në kreun VIII të tij. Rregullorja e programit të studimit jep qartë informacion në lidhje me përmbajtjen e programit dhe stafin akademik të angazhuar. GVJ evidenton një rishikim të rregullores me një afat vlefshmërie 3 vjeçare.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë “Teknologji Informacioni”</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UK ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda institucionit apo institucione të tjera. Ndonëse Neni 61 në Statut përcakton qartë kriteret dhe procedurat e njohjes se krediteve dhe transferimi i studimeve, ato duhet të detajohen në rregulloren e njësisë</p>

bazë, në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore. GVJ gjeti pasqyrimin e transferimit, njohjes së krediteve dhe ekuivalentimit të moduleve në nenin 70 të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe aspak në rregulloren e njesisë bazë. GVJ konstaton në këtë rregullore mungesën e reflektimit të procesit të sistemit të transferimit të studimeve dhe rekomandon plotësimin e tij në përputhje me kërkesën e ligjit të cituar më lart. GVJ konstaton edhe mungesën e paraqitjes së Rregullores së UK-se për Veprimtarinë e Komisionit të Ekuivalentimit të Moduleve dhe Programeve Mësimore.

Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor dhe përmbajtjen e programit. Sondazhi kryesor për vitin akademik 2010 – 2021 tregon që 75% e studentëve në këtë program pranuan që janë të informuar në fillim të vitit akademik për lëndët e përfshira në programin e studimit. Kuotat që janë në dispozicion të transferimeve përbëhen nga kuota të paplotësuara nga regjistrimet e vitit e mëparshëm dhe transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik jo më vonë se java e pestë e semestrit të parë. Si kriter në transferimin e studentëve është ngjashmëria në programin e studimit të ndjekur nga kandidatë në ILA-te publike ose jo publike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja. GVJ konstaton transferim vetëm të 2 studentëve për vitin akademik 2018-2019 në vitin e III.

Viti Akademik	Të regjistruar për herë të parë në vitin e I-rë	Nota mesatare në hyrje	Student të transferuar
2018-2019	26	6.9	2 në vitin e III-të
2019-2020	27	7	-
2020-2021	28	7.3	-

Shtojca 1.1 Statuti i UK

Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli

Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe

procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

kohëzgjatja akademike është 3 vite akademike. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. GVJ konstaton një strukturim të programit “Teknologji Informacioni” në tre vitet e fundit, (ndarja në kredite dhe orëve në auditor sipas semestrave dhe viteve akademike, ndarja e krediteve dhe orëve në leksion, ushtrime/laboratore për çdo modul) të bazuar shtojcën nr.1, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit nr.15 datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Larte”. Pika 12 në këtë rregullore mirë përcakton edhe detyrimet e studentëve në lidhje me frekuentimin i cili për leksionet është fakultativ ndërsa për seancat e seminareve dhe laboratorëve është i detyrueshëm. Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur në manualin përmbledhës të informimit që u pasqyrohet studentëve në fillim të vitit të pare si edhe në syllabuset e programit mësimor. Procedura e vlerësimit të vazhduar të studentëve kryhet gjate semestrit akademik dhe finalizohet me provimin në fund të semestrit dhe shpalljen e përfundimeve. Vlerësimi i tij bëhet në tërësi përmes angazhimit të tij në leksione dhe seminare, plotësimit të detyrimeve dhe frekuentimit, rezultateve të provimeve të pjeshme dhe finalizimit me provimin përfundimtar të cilat janë të mirë përcaktuar në nenin 55, dhe 56 të Rregullores së Njësisë Kryesore. Vlerësimi i vazhdueshëm është 30% ndërsa provimi në fund të semestrit është 70%. Në vlerësimin e vazhdueshëm ndjekja dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 15%, plotësimi i detyrimeve laboratorike 15%, testimet gjatë vitit dhe kolokiume 15-25%. Pedagogu komunikon rezultatet e vlerësimit të vazhdueshëm tek studentët përpara hyrjes së tyre në provimin final dy ditë përpara provimit. Komunikimi bëhet online ku hidhet rezultati i pikëve dhe fitimi i të drejtës për të hyrë në provim.

Ngarkesa totale e studentëve në auditor është:

- Leksione: 1059 orë;
- Seminare: 7 orë;
- Ushtrime/ laboratorë: 1077 orë;

GVJ konstaton 0 orë në format e kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor dhe 0 orë në praktiken profesionale.

Bazuar edhe në kërkesën e vete studentëve, GVJ rekomandon që praktika profesionale të përfshihet në

program si një domosdoshmëri në përputhje me kuadrin ligjor për programet e ciklit të parë

Pedagogu i lëndës (modulit) bën edhe gjenerimin e procesverbalit në sistemin digjital sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i njësisë bazë. Rregullorja e programit dhe njësisë kryesore [neni 57-65] përcakton qarte edhe mënyrën e organizimit të provimit me shkrim. Procedura e ankimit është e pasqyruar në Statut, në Rregulloren e UK-së, Rregulloren e Njësisë Kryesore [neni 67] dhe në Rregulloren e programit të studimit. Pavarësisht situatës së krijuar të pandemisë, provimet janë zhvilluar në auditor. Provimi organizohet në përputhje me rregulloret bazë institucionale duke ruajtur anonimatën përmes procedurës së sekretimit. GVJ konstatoi në vizitën e kryer që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit, procesin e ankimit ndonëse nuk sollën shembuj të përdorimit të kësaj praktike nga ana e tyre.

Institucioni angazhon edhe sekretarinë mësimore për informimin e studentëve në lidhje me detyrimet, rezultat e vlerësimit të tyre. Sekretaria mësimore funksionon mbi bazën e një Rregullore të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 398 datë 22.07.2019. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për procesin e regjistrimit të studentëve, për arkivimin e çdo regjistrimi, dokumenti apo transkripti, për mbajtjen e të dhënave në lidhje me numrin e studentëve aktive, studentët që përfitojnë bursë ekselence, arkivimin e kopjeve origjinale të procesverbaleve dhe notave, ruajtjen e rezultateve të provimit, të arkivojë dosjet e studentëve të diplomuar. GVJ shqyrtoi dokumentacionin dhe në vizitën e kryer në zyrën e sekretarisë mësimore të vendosur në katin e parë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane kontrollloi dhe verifikoi mënyrën e administrimit të të dhënave të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistra baze, regjistrin e notave, të diplomimit dhe çdo regjistër tjetër të parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi dhe gjeti një përputhje midis detyrave të përcaktuara në rregullore neni 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 të tij dhe në praktikën e kryer në këtë zyre dhe mbajtjen e tij në formë *hard copy* dhe në formë elektronike.

Shtojca 1.10 Rregullore e sekretarisë mësimore

Shtojca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore

	<p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë "Teknologji Informacioni"</i></p> <p><i>Shtojca 3.11 Grafiku i takimeve në kuadër të informimit të studentëve të viteve të para (praktika e informimit të studentëve me programin e studimit)</i></p> <p><i>Shtojca 4.1 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB</i></p> <p><i>Shtojca 4.2 Shpallje konkursi për personel akademik (format shpallje vendi vakant)</i></p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumentet bazë institucionale përcaktojnë qartë edhe detyrimet e studentit për procesin e diplomimit. Diplomimi bëhet bazuar në nenin 108 "Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore" e UK-së. Në përfundim të kursit të plote të studimeve, studenti ka të drejtën të diplomohet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi sipas përcaktimeve që janë bërë në këtë rregullore. Në përfundim të studimeve studenti ka të drejtën të diplomohet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi. Të drejtën për teze diplome e kanë studentët që kanë mesatare të ponderuar jo më pak se 7 (në përfundim të semestrit të pestë) ndërsa ata që nuk plotësojnë këtë kriter i nënshtrohet provimit të formimit. Teza për provimin e formimit përmban 20% pyetje për të matur njohuritë nga baza e programimit, 40% për elementë të avancuar të programimit, zhvillimi i site-ve dhe aplikacioneve në internet dhe 40% në lidhje me bazën e elektronikës dhe telekomunikacionit. Studenti informohet në lidhje me bazën e pyetjeve përmes fondit të pyetjeve të cilin e merr në sekretarinë mësimore në fund të semestrit të parë të vitit të tretë. Departamenti i Informatikës ka hartuar edhe një Udhëzues për Punimin e Diplomës Bachelor dhe Master Professional e cila u vihet në dispozicion studentëve në prag të diplomimit të tyre. Për përgatitjen e temës së diplomës përcaktohet edhe udhëheqësi i saj i cili bashkëvepron me studentin në përgatitjen e temës në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Rregulloren e Njesisë Bazë dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Tema e diplomës i nënshtrohet edhe oponencës teknike përmes një sistem pikëzimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 pikë për zgjedhjen e temës; - 15 pikë për strukturën e punimit; - 20 pikë për metodën e punës dhe kërkimit; - 25 pikë angazhimi i studentit;

- 25 pikë qartësia e të shkruarit dhe trajtimi;
- 5 pikë përfundimi;
- 5 pikë vlerësimi i posaçëm i pedagogut;

GJ konstaton 4 studentë për vitin akademik 2018-2019 dhe 3 studentë për vitin akademik 2020-2021 të diplomuar me teze diplome. Në fund të procesit të diplomimit studenti pajiset me diplomën edhe me suplementin e saj dhe nga institucioni organizohet edhe një ceremoni për studentët e diplomuar.

Tabela: studentët e diplomuar për periudhën 2018-2020

Viti Akademik	Nota mesatare në hyrje	Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë	Numri i studentëve të diplomuar	Nota mesatare e studentëve të diplomuar
2018-2019	6.9	26	36	5.6
2019-2020	7	27	27	5.5
2020-2021	7.3	28	6	6.8

GVJ konstaton një rritje të cilësisë së studentëve në hyrje e cila reflektohet edhe me një rritje të mesatares së ponderuar të studentëve në diplomimin e tyre.

Shtojca 1.1 Statuti i UK

Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli

Shtojca 1.2 Rregullorja e UK

Shtojca 2.1 Vendim për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë, Teknologji Informacioni, në Universitetin Fan S. Noli, Korçë (VKM hapjen program studimi)

Shtojca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore

Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë "Teknologji Informacioni"

Shtojca 2.6 Suplementi i diplomës

Shtojca 2.6.1 Diploma bachelor në teknologji informacioni

Shtojca 2.14 Udhëzues për punimin e diplomës bachelor dhe master profesional (udhëzues për punimin e diplomës TI)

Shtojca 2.30 Model teze provim formimi

Shtojca 3.26 Të dhëna statistikore për studentët e programit të studimit ti

Shtojca 3.38 Model vlerësimi oponent udhëheqës temë diplome

Shtojca 3.34 Studentët dhe pedagogët udhëheqës për punimet e diplomës programi i studimit bachelor në "Teknologji

	<p><i>Informacioni (studentet e diplomuar me temë diplome 2019-2020-2021)</i></p> <p><i>Shtojca 3.17 Model i procesverbalit të diplomimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik UK përgatit edhe një udhërrëfyes i cili pasqyron programet mësimore, të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe formën e organizimit të procesit mësimor. Në UK është e ngritur edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) që ofron shërbimin e mbështetjes për maturantët para dhe gjatë procesit të pranimit në UK. Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të kësaj zyre u theksua zgjerimi i spektrit gjeografik të punës me maturantët duke e shtrirë edhe në rrethe të tjera jashtë Korçës për të rritur sensibilizimin në lidhje me programin mësimor. Departamenti i Informatikës ka ndërmarrë edhe një studim tregu për programin mësimor në vitin akademik 2018 -2019. Nga pyetësori i plotësuar me maturantët, 95% e tyre shprehin edhe dëshirën për të vazhduar studimet në programin mësimor TI, dhe 40% midis tyre shprehin dëshirën të studiojnë në programe të ciklit të parë që është një kombinim i dy fushave si TIK dhe Matematikë, TIK dhe biznes.</p> <p><i>GVJ shpreh rekomandimet e tij për tu punuar më shumë në këtë drejtim në përshtatje me kërkesat dhe avantazhit që vetë rrethi i Korçës po jep në drejtim të digjitalizimit (konsiderojmë këtu projektin e Bashkisë së Korçës "Global Digital City") e cila nga vetë përfundimet e anketimit në studim tregu nga Departamenti I Informatikës është konsideruar një avantazh.</i></p> <p>Për vitin 2021-2022 si pasojë e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 takimet informuese "Dita e Informimit të maturanteve 2021" janë zhvilluar online në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Para Universitar përkatësisht në datat 22 shkurt – 31 Mars, 2021</p> <p><i>Shtojca 2.32 Udhërrëfyesi i studentëve 2020-2021</i></p> <p><i>Shtojca 3.10 Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve</i></p> <p><i>Shtojca 3.12 studime të tregut të punës dhe anketime për programin e studimit Teknologji Informacioni (studim periodik tregu)</i></p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e saj. Ata janë në dijeni për detyrimet në lidhje me lëndët formuese sipas nivelit Bachelor të diplomës që ata zotërojnë. Kjo është përcaktuar qartë edhe në kriteret e pranimit në Rregulloren e programit të studimit Në fillim të vitit akademik dhe në fillim të çdo lënde bëhet prezantimi nga ana e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi syllabusi i lëndës dhe detyrimet që duhet të plotësojnë studentët. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar në lidhje me përmbajtjen dhe strukturën e lëndës nga pedagogët e tyre</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni shpërndan informacion tek studentët përmes :</p> <ul style="list-style-type: none">- Njohjes së tyre me dokumente bazë institucionale si Statut, Rregullore të UK-se, Rregullore të Njësisë Kryesore dhe Bazë, Rregullore të programit të studimit;- Website ku lëndët (modulet) e programit mësimor informojnë studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë;- Për informimin e studentëve përdoren edhe faqet sociale si facebook https://www.facebook.com/unkorce/- UK harton udhërrëfyes për çdo vit akademik duke bere informimin e studentëve që regjistrohen për herë të parë.- Informimi i studentëve bëhet edhe nga stafi akademik në fillim të lëndës /modulit përmes paraqitjes së syllabusit dhe përmbajtjes së tij;- Studentët njihen në fillim të çdo semestri akademik me orarin mësimor i cili publikohet online dhe afishohet edhe në stendën e informimit në katin e parë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane; <p>Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor edhe përmes sekretarisë mësimore duke u njoftuar për lëndët, regjistrimin përkatës, grupet dhe rezultatet e provimeve</p> <p><i>Shtojca 3.11 Grafiku i takimeve në kuadër të informimit të studentëve të viteve të para (praktika e informimit të studentëve me programin e studimit)</i></p>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.

Zyra e Karrierës dhe Alumni punon tre shtylla kryesore: maturantët, studentët dhe alumni. Veprimtaria e saj është e gjerë në mbështetje të procesit të informimit me maturantët përmes takimeve që zhvillohen me shkollat e mesme në përputhje me grafikun e miratuar, organizimit të trajnimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca në bashkëpunim me Këshillin Studentor dhe ndjekjes së studentëve të diplomuar dhe gjurmimit të tyre duke rifreskuar edhe sesionin Studentë/ Qendra e Karrierës dhe Alumni/ Statistika në çdo vit akademik. Të dhënat e mbledhura nga kjo zyrë duke angazhuar edhe studentë me baza vullnetarizmi dhe veprimtaria e saj shprehet edhe në raportet vjetore që kjo qendër harton dhe ju bën me dije stafit akademik dhe njësive baze. QKA organizon në çdo vit akademik panairin e punës dhe publikon oferta punësimi. Kjo qendër zhvillon punë serioze në lidhje me gjurmimin e studentëve pas diplomimit të tyre. Për vitin akademik 2017-2018 të dhënat statistikore të mbledhur nga Qendra e Karrierës dhe Alumni janë përmirësuar duke u fokusuar në punësimin e studentëve kundrejt sektorit publik dhe privat. Për këtë vit rezultojnë që numri i studentëve të punësuar në sektorin publik është 3 dhe në sektorin privat është 4 studentë.

Për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë që numri i studentëve të punësuar në sektorin publik është 1 dhe në sektorin privat është 1 studentë.

Për vitin akademik 2020 dhe 2021 të dhënat statistikore janë më pak treguese dhe nuk japin një panoramë të qartë të gjurmimit të studentëve në lidhje me punësimin e tyre sidomos në dy sektorët përkatësisht publik dhe privat ashtu siç reflektohen edhe në tabelën më sipër.

Viti akademik	Nr. i studentëve të diplomuar të	Nr. i studentëve të punësuar	Nr. I studentëve të vetëpunësuar	%	Nr. studenteve të papunë	Nr. i studentëve të padeklaruar	Nr. i studentëve që vazhdojnë
2016-2017	15	8	0	53.3	2	5	0
2017-2018	36	8	1	22.2	5	14	9
2018-2019	42	3	1	7.1	1	9	8
2019-2020	29	5		17.2	3	18	3

	<p>GVJ konstaton një rënie të numrit të studentëve të punësuar. GVJ shqyrtoi pyetëtorin e gjurmimit të studentëve për vitin akademik 2021 dhe përmbledh që rezultatet e përfuara në të janë të përgjithshme dhe nuk përcaktojnë qartë problematikën për këtë program studimi. Përqindjet e përgjigjeve në lidhje me pyetjet,</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Pas diplomimit a ju ka ndihmuar institucioni juaj arsimor për të gjetur vend pune?</u> - <u>A keni marrë trajnim shtesë për pozicionin aktual?</u> <u>Etj.</u> <p>Të cilat janë në nivel universiteti dhe aspak në nivel programi.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të dhënat statistikore duhet të jene specifike në mënyrë që të përcaktohet qartë cilësia e programit mësimor kundrejt punësimit të studentëve dhe të ndiqet një plan veprimi konkret në lidhje me drejtimet e përmirësimeve që duhet të ndërmerren nga Departamenti i Informatikës, madje ky i fundit duhet të shprehë interesim më të madh për këto rezultate për ti shprehur më qartë në përmbajtjen e punës së tij.</i></p> <p>Edhe pse njësia bazë, ka realizuar anketime të pavarura nga ai institucional, gjë që vlerësohet pozitivisht nga GVJ, sugjerojmë që kjo praktikë të përmirësohet më tej.</p> <p><i>Shtojca 3.20.1 Analiza vjetore e QKA për vitet 2018-2019 (qendra e karrierës dhe alumnit)</i></p> <p><i>Shtojca 3.20.2 Analiza vjetore e QKA për vitet 2019-2020 (qendra e karrierës dhe alumni)</i></p> <p><i>Shtojcat 3.24.1, 3.24.2, 3.24.3 dhe 3.24.4 Të dhëna për gjurmimin e studenteve të diplomuar 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2020</i></p> <p><i>Shtojca 3.33 Anketë gjurmim punësimi zhvilluar DI 2021</i></p> <p><i>Shtojca 2.33 Njoftime punësimi QKA</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Informatikës mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime. Përmes punës së tij studentët informohen në lidhje me të drejtat, detyrat dhe udhëzimet informuese për procesin mësimor. Informacion shpërndahet edhe përmes :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Manuale udhëzuese; 2. Staf i akademik i cili ka një komunikim bashkëpunues me studentë duke konsideruar edhe numrin e ulët të tyre në programin mësimor; 3. Sistemi ESSE 3;

	<p>4. Website dhe rrjetet sociale si facebook, instagram janë forma të përdorura për një shpërndarje sa më të gjerë të informimit;</p> <p>5. Sekretarisë mësimore;</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Institucioni ka vënë në funksion sistemin ESSE3 i cili është i aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik dhe përmes të cilit administrohet i gjithë informacioni për programin mësimor, progresin dhe rezultatet e studentëve deri në diplomimin e tyre. GVJ konstatoi që ky sistem është funksional dhe i qëndrueshëm. Informacioni në këtë sistem përhapet lehtësisht dhe zyra e IT-së e ngritur në këtë institucion shërben për mirëmbajtjen dhe mirë administrimin e tij.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>UK zotëron struktura të cilat menaxhojnë sistemin e informacionit për numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi, për progresin e tyre dhe detyrimet që ata mbartin. Një nga strukturat më të rëndësishme është sekretaria mësimore e ngritur në çdo Fakultet. Sekretaria mësimore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e UK-së, Rregullores se Njësisë Kryesore, Rregullores së Departamentit të Informatikës. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për arkivimin e çdo regjistrimi, për dhënie informacioni dhe dokumenti në lidhje me studentet. Zyra e Sekretarisë mësimore funksionon <i>mbi bazën e një rregullore të aprovuar nga Senati Akademik.</i></p>

	<p>Të dhënat në lidhje me progresin e studentëve mbahen edhe nga stafi akademik. Regjistri i pedagogut përcakton edhe frekuentimin e studentëve në lidhje me lëndën apo modulin dhe plotësimin e detyrimeve në lidhje me orët e ushtrimeve, aktivizimin e studentëve dhe plotësimin e detyrimeve në orët laboratorike. Departamenti i Informatikës në bashkëpunim me sekretarinë mësimore disponon dhe administron të dhënat statistikore të studentëve në lidhje me procesverbalet e plotësuar nga stafi akademik për provimet e organizuara, procesin e diplomimit. FSHNH dhe UK në Kreun IX neni 92 në Rregulloren e Njesisë Kryesore garanton ruajtjen e të dhënave personale të studentëve bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren e FSHNH.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p> <p><i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.3 Plani strategjik UNIKO 2016-2020</i></p> <p><i>Shtojca 2.1 Vendim për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë, Teknologji Informacioni, në Universitetin Fan S. NOLI, Korçë (VKM hapjen program studimi)</i></p> <p><i>Shtojca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore</i></p> <p><i>Shtojcat 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3 Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë "Teknologji Informacioni"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbështetur në ligjin nr.80/2015 të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Regjistri themeltar i studentëve;</i> - <i>Regjistri i arritjeve akademike;</i> - <i>Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave;</i> <p>Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore dhe nga takimi me kryesekretare dhe sekretaren në këtë zyrë konkludon:</p> <p>Regjistrimi manual dhe online i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit janë në përputhje me nenin 4 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuar për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen</p>

	<p>edhe në regjistrin elektronik për të cilën u bë edhe një verifikim nga ana e GVJ-së. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën nr.2 të udhëzimit nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”.</p> <p>GVJ gjeti regjistrimin përfundimtar të studentëve me numrin e matriculimit në përputhje me nenin 15 në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe në tërësi plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe lëshimi i saj me suplementin e diplomës bëhet nga vete studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar, studentët e transferuar, studentët që largohen. Të dhënat ruhen në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Të dhënat ruhen edhe në Departamentin e Informatikës. Në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, Departamenti i Informatikës pasqyron edhe përpunimin statistikor të progresit të studentëve për çdo vit akademik në raportet vjetore.</p> <p><i>Shtojca 2.20 Analiza vjetore e veprimtarisë së UNIKO 2018-2019</i> <i>Shtojca 2.21 Analiza vjetore, veprimtaria akademike 2019-2020</i> <i>Shtojca 2.29 Analiza mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 (analiza vjetore FSHNH)</i> <i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës</i> <i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021</i> <i>Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit “Kriptografi” (pyetësori i stafit akademik model)</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve</p>	<p>Të dhënat e studentëve ruhen edhe në formë elektronike. Platforma ESSE3 ofron qasje informacioni në lidhje me</p>




menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

studentët e regjistruar, progresin e tyre në procesin mësimor dhe diplomimin e tyre. Të dhënat e studentëve mbahen edhe në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli. Diskutime në lidhje me mënyrën e arkivimit dhe ruajtjes së të dhënave u gjet edhe në takimet e zhvilluara me përfaqësues të IT. Një pjesë e të dhënave administrohen edhe në sistemin ESSE3 ku na u garantua edhe ruajtja e konfidencialitetit dhe garancisë së vërtetësisë së tyre. Nëse një mospërputhje ekziston, atëherë të dhënat me shkrim në regjistrat bazë prevalojnë. Në takimet e zhvilluara u theksua që UK mbron, ruan, dhe administron të dhënat personale edhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

UK në zbatim të udhëzimit MASR nr.5 datë 19.02.2018, në fund të çdo viti akademik përgatit edhe raportin vjetor i cili është i hartuar mbi bazën e evidencave të paraqitura në raportet vjetore të Njësisë Bazë dhe Njësisë Kryesore. Raportet vjetore pasqyrojnë profilin e cilësisë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si edhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. GVJ shqyrtoi edhe raportet vjetore të përgatitura nga Departamenti i Informatikës dhe konstaton që elementët përbërës së tij pasqyrojnë qartë dinamikën, problematikën dhe rekomandimet e duhura për përmirësimet e nevojshme.

Shtojca 2.20 Analiza vjetore e veprimtarisë së UNIKO 2018-2019

Shtojca 2.21 Analiza vjetore, veprimtaria akademike 2019-2020

Shtojca 2.29 Analiza mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 (analiza vjetore FSHNH)

Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës

Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021

Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit “Kriptografi” (pyetësori i stafit akademik model)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

përmirësimi të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, ligjit të Arsimit të Lartë pika 2, në draft paktin për universitetin është parashikuar edhe rritja e përfaqësimit të studentëve në proceset vendimmarrëse brenda universitetit. Bazuar në nenin 68 në Statut të UK-së studentët kanë përfaqësimin e tyre në nivel Senati Akademik dhe në Komisionet e Përhershme. Studentët kanë Këshillin e tyre Studentor i cili funksionon mbi bazën e një rregullore miratuar në 2017</p> <p><i>Shtojca 1.17 Rregullore e këshillit studentor</i></p> <p><i>Shtojca 2.19 Draft pakti për universitetin</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje (detyrime këto që rrjedhin tek Kodi i Cilësisë). Studentët kanë përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse. Si pasoje e draft paktit mbi universitetet, është konstatuar një rritje e përfaqësimit të studentëve në organet kolegjiale. Tashmë studentët kanë përfaqësimin e tyre në Bordin e Administrimit, Këshillin e Etikës dhe në Komisionet e Përhershme.</p> <p>Përfaqësimi i tyre është në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Senatin Akademik – 2 studentë; b. Këshillin e Etikës – 1 studentë me mesatare mbi 8.5 i zgjedhur mbi bazën e vet-kandidimit nga Senati Akademi; c. 1 studente në Bordin e Administrimit; d. Nga 1 studentë në Komisionet e Përhershme si vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit e Kërkimit Shkencor; • Komisioni i Zgjedhjeve; <p>Këshilli studentor i ngritur funksionon mbi bazën e veprimtarisë së Këshillave Studentore të ngritur në çdo Fakultet. Në planin strategjik të zhvillimit si pikë e dobët nga Departamenti i Informatikës është vënë: “Mungesa e përfshirjes së studentëve në vendimmarrjen e PSCP “TI”. Edhe pse studentët janë angazhuar në Këshillin e Studentëve, në Senat dhe në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHNH, ata spontanisht janë bërë pjesë e diskutimeve të problematikave të TI-së dhe</p>

menaxhimit të tyre. Me përgatitjen e vlerësimit të brendshëm të sigurisë në rang program studimi, parashikohet edhe pjesëmarrja e një studenti në grupin e posaçëm”.

GVJ mbështet mendimin e Departamentit të Informatikës për një pjesëmarrje më reale të studentëve nga programi i studimit në procesin e vendimmarrjes dhe angazhimit aktual të tyre në grupet e punës kur diskutohen çështje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë program studimi.

Shtojca 1.1 Statuti i UK

Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Institucioni ndërmerr sondazhe të studentëve për të matur cilësinë e programit të studimit. Programi mësimor nuk ka pësuar përmirësim. Ngarkesa e studentëve në auditor është:

Viti akademik	Semestri	Totali	Orë leksioni	Orë ushtrime	Orë laboratorik e/Seminare
2020-2021	I	744	360	379	10
	II	744	376	361	7
	III	655	323	332	

Ngarkesa e studentëve jashtë auditorit është:

- Viti I: 1389 orë;
- Viti II: 644 orë;
- Viti III: 835 orë ;

Ngarkesa javore varion:

- Viti I semestri I: 12 orë leksione dhe 12,8 orë laboratorike/ ushtrime;
- Viti I semestri II: 12 ora leksione dhe 12,8 ora laboratorike/ ushtrime;
- Viti II semestri I: 12.5 orë leksioni, 0.5 orë seminare/detyra kursi dhe 11 orë laboratorike;
- Viti II semestri II: 12 orë leksioni dhe 13 orë laboratorike;
- Viti III semestri I: 12.5 orë leksioni, 12.5 orë ushtrime;
- Viti III semestri II: 9 orë leksione dhe 9.5 orë ushtrime;

<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët janë pjesë e procesit të rishikimit të programit mësimor. Përmes plotësimit të anketimit ata shfaqin mendimin e tyre në lidhje me dobësitë në procesin mësimor dhe shërbejnë si mjet për ndërmarrjen e hapave në lidhje me përmirësimet që kërkohen. Ndonëse Departamenti i Informatikës mat cilësinë e programit të studimit përmes pyetësorëve të studentëve apo studimit të tregut, GVJ nuk gjeti ndryshime në planin mësimor apo në syllabuset e lëndëve. Ngarkesa e studentëve në tre vitet e fundit ka mbetur e njëjtë me shifrat e paraqitur me sipër në auditor ashtu edhe jashtë tij.</p> <p><i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021</i> <i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UK ofron për çdo student një pyetësor për vlerësimin e lëndës apo modulit. Pyetësori mundëson studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërben si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimit nga ana e Departamentit të Informatikës. Dokumentet bazë si Rregullore e UK-së, Rregullore e Njësisë Kryesore dhe e Programit mundëson studentët të kenë të drejtën të njohë mënyrën e vlerësimit të tij gjatë procesit mësimor. Organizimi i provimit, njohja me vlerësimin e tij, afatet kohore për ankimimin janë të përshkruar në dokumentet bazë. Institucioni bën punë në lidhje me informimin e studentëve që në momentin e regjistrimit të tyre për herë të parë me njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Nga takimi me studentët GVJ konstaton që studentet ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të tyre nga ana e stafit akademik, mënyrën e ankimimit ndonëse siç jemi shprehur edhe më përpara nuk sollën shembuj të eksperiencës së tyre në këtë drejtim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi V.6




Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në fokus të veprimtarisë së saj UK ka parimin e informimit të studentëve. Në lidhje me këtë strukturat kolegjiale dhe administrative bashkërendojnë punën e tyre për të siguruar që informacioni shpërndahet në stafin akademik dhe tek studentët. Informimi i studentëve sigurohet përmes përdorimit të formave siç vijon me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Takimet informuese në fillim të vitit akademik;- Udhërrëfyese që UK përgatit çdo vit dhe jep një informacion të përgjithshëm në lidhje me programet mësimore, të drejtat dhe detyrimet e studentëve;- Faqja web ku FSHNH paraqet syllabuset e programit mësimor “Teknologji Informacioni”;- Njoftime punësimi, trajnime dhe konferenca bëhen nga zyra e QKA;- Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet;- Informacioni buron edhe nga biblioteka e cila siguron material të nevojshëm përmes platformave të saj elektronike, ku studentët kane mundësi të aksesojnë në literature suplementare të nevojshme;- Udhëzimet dhe ndryshimet në kuadrin ligjor transmetohen përmes strukturave deri tek stafi akademik dhe studentët;- Sekretaria mësimore e cila informon studentët për tarifën e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm;- Sensibilizimi dhe informimi në situatën e krijuar nga pandemia ka bërë që institucioni të shfrytëzojë edhe faqet sociale si facebook për të rritur komunikimin dhe informimin me studentët;- Platforma ESSE3 siguron një komunikim interkativ studentë institucion dhe në kohe reale siguron informacion, regjistrim dhe përgjigje për shumë çështje që kanë të bëjnë me orët mësimore, grafikun e provimeve, regjistrimin e studentëve, rezultatet e provimeve dhe i mundëson ata për procesin e ankimimit;

	Broshura, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore;
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UK ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të ngritura të saj. Të gjitha funksionojnë bazuar në Rregulloren e UK, Rregulloren e Njesisë kryesore dhe Njesisë Bazë, Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloreve të veçanta të miratuara nga Senati Akademik. Vlen të përmenden me kryesoret që ndikojnë dhe ofrojnë informimin dhe këshillimin:</p> <p>Njësia bazë e cila bazuar edhe në nenin 15 të rregullores së saj ka përcaktuar edhe koordinatorin e programit të studimit detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit rrjedhin nga Kodi i Cilësisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria mësimore - QKA - NJSBC <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me përfaqësues të këtyre strukturave, dhe takimet me studentët evidenton që ato janë aktive dhe ofrojnë ndihmë dhe këshillim për studentët. Vlen të përmendet edhe ndihma që vetë stafi akademik u ofron studentëve. Duke konsideruar numrin e ulët të tyre, GVJ gjeti një komunikim të lartë të stafit me studentët dhe këta të fundit shprehen në takim edhe ndihmën që pedagogët ofronin për çdo vështirësi që ata hasnin në procesin mësimor jashtë orëve të mësimi. Kjo ndihmë është theksuar më shumë gjatë situatës së Covid-19 ku stafi akademik ka qenë i gatshëm për çdo paqartësi të studentëve dhe i ka mbështetur ata në çdo kohë</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>UK ka ngritur edhe Qendrën e Karrierës dhe Alumni e cila është një strukturë aktive në lidhje me punën e saj me studente. Siç jemi shprehur edhe me përpara kjo qendër ka në fokus të saj: Maturantët, studentët dhe alumni. Forma e veprimtarisë së saj mbështet në tre shtylla kryesore që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi (këshillim karriere) ; - Trajnim (këshillim për studentët aktuale; - Ndërmjetësim me punëdhënësit (mundësi punësimi për studentët); <p>QKA ofron informim dhe orientim profesional përmes dhënies së informacionit për bursa, konferenca studimore,</p>

<p>tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>informacion në lidhje me mobilitetin e studentëve. Në lidhje me këshillimin profesional kjo qendër në bashkëpunim me njësinë bazë organizon leksione të hapura mbi këshillimin e karrierës, mënyrën e përgatitjes së CV-së dhe intervistave me punëdhënësit etj. Përmes Panairit të Karrierës ajo ofron kompanitë private dhe shtetërore të lidhen me studentët dhe këta të fundit të kuptojnë edhe kërkesat dhe të krijojnë kontakte për aplikime për punë. QKA në bashkëpunim edhe me Këshillin Studentor mbështet veprimtarinë e studentëve në aktivitetet e tyre dhe për vitin 2019-2020 ka bashkëpunuar në hartimin e një drafti të ri të rregullores për zgjedhjet e Këshillit Studentor në nivel Universiteti i cili më pas do të vijohet edhe me miratimin përfundimtar në Senatin Akdemik. QKA bashkëpunon me zyrat e punës dhe Agjencisë Rajonale për Zhvillim në Korçë, me kompanitë private për të rritur mundësinë e zhvillimit të praktikave profesionale dhe punësim të studentëve të diplomuar. Duke konsideruar që programi i ciklit të parë “Teknologji Informacioni” nuk ofron praktike profesionale, rishikimi i tij nga ana e Departamentit të Informatikës duke inkorporuar praktikën në përmbajtjen e programit është e nevojshme dhe lehtësisht e realizueshme duke konsideruar bashkëpunimet që institucioni dhe QKA ka me kompanitë private dhe institucionet shtetërore.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>QKA në bashkëpunim edhe me njësinë bazë punon në lidhje me gjurmimin e studentëve dhe punësimin e tyre. GVJ konsideron punën e realizuar në vite nga kjo qendër në lidhje me mbledhjen e të dhënave statistikore të studentëve të diplomuar dhe të punësuar të cilat reflektohen edhe në raportet vjetore që njësia bazë harton në fund të çdo viti akademik.</p> <p><i>Në këtë drejtim GVJ mbështet edhe rekomandimin e dhënë në seksionet më sipër për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe vazhdimin e gjurmimit të studentëve duke diferencuar të dhënat statistikore për çdo program studimi, të cilën e konsiderojmë të nevojshme për të matur impaktin dhe cilësinë e programit të studimit dhe për marrjen e masave konkrete në përmirësimin e tij nga ana e Departamentit të Informatikës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UK është përgjegjës për sigurimin e sistemit të brendshëm të cilësisë në të gjithë hallkat përbërëse organizative. Në këtë drejtim është ngritur edhe rrjeti i cilësisë që mbështet punën e tij në plotësimin e standardeve shtetërore të cilësisë si edhe në standardet dhe udhëzimet evropiane. Në kreun IX në Statut përshkruhet qartë siguri i cilësisë dhe organizimi strukturor i tij.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Neni 84 përcakton përbërjen e rrjetit të cilësisë nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimin Institucional dhe Alumni i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimin Institucional. Brenda këtij sektori funksionon Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me përfaqësues një Koordinator nga çdo njësi kryesore. Pranë çdo njësie kryesore është ngritur edhe Grupi i Vlerësimin me përfaqësim nga çdo njësi bazë dhe nga këshillat studentore të çdo fakulteti. Rishikimi i Statutit ka përfshirë edhe Komisionet e Përhershëm si organe kolegjiale ku një prej tyre është edhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit e Kërkimit Shkencor që përbëhet nga pesë anëtarë dhe i ngritur në nivel Universiteti dhe nivel të Njesisë Kryesore. UK përcakton në buxhetin e tij fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë. UK në Planin Strategjik të Zhvillimit 2021 – 2026 ndër objektivat kryesore ka: mësimdhënien, kurrikulat, stafi akademik dhe siguri i brendshëm i cilësisë. Siguri i brendshëm i cilësisë dhe përfshirja me aktive e studentëve dhe stafit akademik në proceset e vendimmarrjes përbën edhe objektivin në Strategjinë e Zhvillimit të Programit të Studimit 2021-2025.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i> <i>Shtojca 1.3.1 Draft plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë përfshin marrjen e masave për përmbylljen e proceseve të akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit. Në lidhje me këtë, neni 85 në Statut përcakton krijimin e strukturës së sigurimit të cilësisë në fakultete dhe ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të përbërë nga pesë anëtarë ku një prej tyre është përfaqësues i studentëve. Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni mban kontakte me ASCAL për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. UK i nënshtrohet procesit të vlerësimit të mësimdhënies nga ASCAL në mënyrë periodike dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes Sondazhit Kombëtar të Studenteve. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë bëhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i> <i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>UK garanton sigurimin e cilësisë në dy shtylla kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sigurimin e brendshëm; - sigurimin e jashtëm të cilësisë; <p>UK tashmë ka zhvilluar Sistemin e Brendshëm të Cilësisë që mbështet veprimtarinë e tij në sigurimin, kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë. Pjesë përbërëse e këtij sistemi është edhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e cila mbështet dhe ofron ekspertizë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (DKSCKSH) është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UK dhe është në varësi të Rektorit. DKSCKSH – ja përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (SKSC – 4 anëtarë); – Sektori i Projekteve, Kërkimit Shkencor dhe Digjitalizimit (4 anëtarë); <p>Kjo drejtori kryen veprimtarinë e saj bazuar në Rregulloren së miratuar nga Senati Akademik. Institucioni ka hartuar edhe Manualin e Cilësisë. GVJ konstaton mospërputhje midis përshkrimit të strukturës në Manualin e Cilësisë dhe organizimit strukturor të cilësisë në draft statut. Në Manualin e Cilësisë është theksuar që NJSBC është përbërë nga 6 anëtarë dhe është organ kolegjal ndërsa në Statut përmendet Komisioni i Sigurimit të Cilësisë i përbërë nga 5 anëtarë.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Manuali i Cilësisë ndonëse është miratuar në vitin 2020 ka nevojë të reflektoj ndryshimet e bëra në Statut, në organizimin strukturor të sistemit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë dhe në Rregulloren e DKSCKSH-së.</i></p> <p>Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë zhvillon punën në dy drejtime: Zhvillimin e Programeve Mësimore dhe Sigurimin e Cilësisë. Ky sektor menaxhon edhe rrjetin e cilësisë në shkallë fakulteti dhe universiteti. Detyra kryesore e tij është analizimi, zhvillimi dhe rishikimi i programeve të studimit, planeve mësimore, syllabuseve, lëndët etj. Ky sektor mbikëqyr, promovon dhe orienton përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Punën e tij e bashkërendon me njësinë bazë (Departamentin e Informatikës dhe NJSBC). GVJ gjeti në institucion një strukturë solide dhe aktive. Në takimin me përfaqësues të kësaj strukture u theksua puna e bërë në lidhje me ndjekjen dhe kontrollin e ecurisë së procesit mësimor në përputhje me planet dhe programin mësimor në të gjithë përbërësit e tij.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA)</i></p> <p><i>Shtojca 1.6 Rregullore e ESSE 3</i></p> <p><i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UK 2020</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për</p>	<p>UK përdor mekanizma dhe procese për shqyrtimin dhe monitorimin e programit të studimit. Kjo realizohet përmes:</p>

<p>shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Punës që SKSC kryeson në lidhje me ristrukturimin dhe përmirësimin e programit të studimit. GVJ konstaton se në tre vitet e fundit asnjë përmirësim nuk është bërë në përmbajtjen e programit të studimit ndonëse SKSC përdor mekanizma si pyetësorët me studentët, monitorimin e programit mësimor në të gjithë elementet e tij; - standardeve dhe kritereve të cilësisë së programit të studimit ; <p>GVJ u njoh me raportet vjetore të UK-së dhe të Departamentit të Informatikës të cilat japin një analizë të cilësisë së mësimdhënies, kalueshmëria e shprehur në përqindje për secilën lëndë, analizën kërkimore shkencore të stafit akademik dhe sigurimi i realizimit të masave ku vlen të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së studentëve; - Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte kërkimore shkencore; - infrastrukturës mësimore; <p>Në drejtim të infrastrukturës u konstatua krijimi në dy vitet e fundit i dy laboratorëve të rinj të informatikës të cilët mbulojnë nevojat e studentëve në këtë program studimi.</p> <p><i>Shtojca 1.3.1 Draft plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i></p> <p><i>Shtojca 2.4.2 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit të ciklit të parë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Informatikës në bashkëpunim me SKSC ndërmerr edhe pyetësorë në fund të çdo semestri në lidhje me lëndët e zhvilluara. GVJ konstaton një praktikë të ndërmarrë nga vetë stafi akademik të cilët kanë hartuar një pyetësor të veçantë për të matur cilësinë e lëndës që kanë zhvilluar përmes marrjes së mendimit të studentëve. GVJ konsideron këtë të fundit një praktikë pozitive matëse dhe vlerësuese e ecurisë së programit të studimit. Përmbajtja e pyetjeve në këtë pyetësor janë më specifike dhe ndihmojnë stafin akademik në punën e tij për përmirësimin e përmbajtjes së lëndës.</p> <p><i>Shënime në vizitë</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultat e pyetësorëve reflektohen në raportet vjetore që hartohen nga zyra e SKSC dhe në raportet vjetore të njësisë bazë, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane dhe në nivel institucioni.</p>

<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ gjeti raportet e përgatitura nga SKSC vetëm një përpunim statistikor të të dhënave të mbledhura nga sondazhet me studentët ndërsa rekomandimet i gjeti në raportet vjetorë të njësisë bazë.</p> <p><i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Spektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar plotësohen nga studentët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programit ose në kuadër të akreditimit institucional, bazuar kjo edhe në nenin 85 në Statut të UK-së.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draftstatuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Manuali i Cilësisë përcakton qartë që NJSBC dhe SKSC kryen në vlerësimin e cilësisë së programit mësimor. Këto metoda janë të miratuara nga Senati Akademik në Rregulloren e DKSCSH. GVJ gjeti evidencë të praktikës së përdorimit të pyetësorëve për periudhën 2018-2021 dhe pasqyrimi i tyre në raportet vjetore të institucionit</p> <p><i>Shtojca 2.20 Analiza vjetore e veprimtarisë së UNIKO 2018-2019</i></p> <p><i>Shtojca 2.21 Analiza vjetore, veprimtaria akademike 2019-2020</i></p> <p><i>Shtojca 2.29 Analiza mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 (analiza vjetore FSHNH)</i></p> <p><i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës</i></p>




Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.

SKSC ndërmerr në fund të çdo semestri edhe sondazhe të drejtpërdrejta me studentët në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor, përmbajtjes së lëndës, format e mësimdhënies nga ana e stafit akademik, infrastrukturës, cilësinë e punës së stafit administrativ si sekretaria mësimore, biblioteka, tekstet dhe kapaciteti i librave në bibliotekë. SKSC është përgjegjëse për përpunimin statistikor të tyre të cilat më pas pasqyrohen nga Departamenti i Informatikës në raportet e tij vjetore. Për vitin akademik 2020 – 2021 ky pyetësor është plotësuar online përmes Google forms. Ruajtja e anonimatit është një nga elementët kryesorë i cili ka nxitur edhe vërtetësinë e përgjigjeve. Stafi akademik i Departamentit të Informatikës ndërmerr me iniciativën e tij të aprovuar edhe nga përgjegjësi i njësisë bazë, një pyetësor me studentët që kanë frekuentuar lëndët e programit mësimor. GVJ evidenton një pjesëmarrje më të madhe të studentëve në këtë pyetësor. Nga 42 studentët të kursit kanë marrë pjesë vetëm për lëndën “Kriptografi” 33 studentë në Qershor 2021, kundrejt 20 studentë që ju përgjigjën pyetësorit të organizuar nga SKSC. Pyetjet në këtë pyetësor janë më specifike për modulin, nivelin e vlerësimit, pjesëmarrje në diskutim gjatë orëve të ushtrimeve apo praktikave. Në veçanti ky pyetësor bën edhe vlerësimin e performancës së pedagogut sipas shkallës Likert ku kërkohen mendimi i studentit për atmosferën në auditor, kompetencat profesionale të tij, qartësinë në shpjegim, vlerësim dhe respektin tek studentët, inkurajimin në lidhje me përmbajtjen e lëndës, nxitjen e diskutimeve dhe motivimin e studentëve.

GVJ këtë rubrikë e konsideron më reale, më specifike dhe rekomandon që Departamenti i Informatikës duhet të përpunojë më tej këtë iniciativë

Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit “Kriptografi” (pyetësori i stafit akademik model)

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që

GVJ nuk konstaton intervista të ndërmarra nga SKSC me studentë apo palët e treta të interesuara si kompanitë private dhe shtetërore apo institucionet me të cilat janë lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi. QKA në kuadër të gjurmimit të studentëve të diplomuar ka organizuar edhe një pyetësor për të marrë mendimin në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe vlefshmëria e tij tek studenti i punësuar.

Shtojca 3.13.1 pyetësor studentor 2021;

bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021;</i> <i>Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit "kriptografi" (pyetësori i stafit akademik model);</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale, Rregulloren dhe Manualin e Cilësisë, vënia në funksion e rrjetit të cilësisë që buron nga niveli më i lartë deri në Njësinë Bazë konkludon që në institucion është vendosur sistemi i vlerësimit të brendshëm gjithëpërfshirës dhe aktiv. <i>Shtojca 1.1 Statuti i UK;</i> <i>Shtojca 1.1.1 Draft Statuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli;</i> <i>Shtojca 1.5 Sregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA);</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë UK 2020;</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Brendshme e Departamentit të Informatikës (Rregullore e Dep të Informatikës);</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Raportet vjetore të përgatitur nga QKSC japin një informacion të gjerë në lidhje me mendimin e studentëve për cilësinë dhe përmbajtjen e programit mësimor. Mendimi i studentëve reflektohet edhe në raportet vjetore ku Departamenti i Informatikës reflekton dhe ndërmerr edhe masa konkrete dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësim. <i>Shtojca 3.7.1 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të parë dhe të dytë universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO raporti i vlerësimit të brendshëm 2017-2018);</i> <i>Shtojca 3.7.2 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të parë dhe të dytë universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO raporti i vlerësimit të brendshëm 2018-2019);</i>

	<p><i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës (analiza vjetore e veprimtarisë së njesise baze);</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021;</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit "kriptografi" (pyetësori i stafit akademik model);</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përmbajtja e pyetësorit të përgatitur nga QKSC dhe pyetësorit të përgatitur nga stafi akademik i Departamentit të Informatikës përfshin mendimin e studentëve jo vetëm në lidhje me stafin akademik, por edhe për strukturat ndihmëse dhe administrative. Studentët në sondazhin 2020-2021 kanë reflektuar pozitivisht në lidhje me punën e bërë nga sekretaria mësimore dhe punonjëse e bibliotekës. GVJ konstatoi një pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve, Departamentit të Informatikës, Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane në këtë proces.</p> <p><i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021;</i></p> <p><i>Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit "Kriptografi" (pyetësori i stafit akademik model);</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar edhe në Statut, liria akademike edhe themelore në funksionimin e Institucionit. GVJ nuk gjeti evidencë të prekjës së integritetit të stafit akademik, personeli ndihmës – akademik në këtë drejtim.</p> <p><i>Shtojca 1.1 Statuti i UK;</i></p> <p><i>Shtojca 1.1.1 Draft Statuti i ndryshuar i universitetit fan s. noli;</i></p> <p><i>Shtojca 1.20 Kodi i Etikës së UNIKO;</i></p> <p><i>Shtojca 1.23 Rregullorja për konfliktin e interesave për ushtrimin e funksioneve publike;</i></p> <p><i>Shtojca 1.22 Rregullorja e përfutimit të vitit sabbatik;</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Programi mësimor "Teknologji Informacioni" nuk përfshin praktikën profesionale, por kjo nuk përjashton edhe mundësinë nga ana e Departamentit të Informatikës në lidhje me përthithjen e mendimit të kompanive të biznesit. Departamenti i Informatikës ka ndërmarre edhe një studim tregu por, GVJ konsideron që intervista, pyetësorët dhe alumni duhet të japin mendimin e tyre për programin e studimit dhe hapat që duhet të ndërmerren në lidhje me përmirësimin e tij.</p> <p><i>Shtojca 2.7.1 Plani mesimor i programit të studimit ti 2018-2019;</i></p> <p><i>shtojca 2.7.2 Plani mesimor i programit të studimit ti 2019-2020;</i></p>

	<p><i>shtojca 2.7.3 Plani mësimor për programet e studimit me kohë të plotë 2020-2021 (plani mesimor i programit të studimit të 2020-2021);</i></p> <p><i>shtojca 2.8.1 Programet lëndore të programit të studimit të ciklit të parë;</i></p> <p><i>shtojca 2.8.2 Programet lëndore të programit të studimit të ciklit të parë;</i></p> <p><i>shtojca 2.8.3 Programet lëndore të programit të studimit të ciklit të parë;</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit përfshin shumë grupe të interesit. Ndonëse në vëmendje është mendimi i studentëve, në këtë proces GVJ konstaton edhe përfshirjen e stafit akademik, Departamentit të Informatikës, SKSC, Rektoratit dhe Senatit Akademik. Të dhënat e mbledhura u komunikohen të gjithë hallkave dhe në lidhje me to merren edhe masat e nevojshme. Të dhënat bëhen publike dhe pasqyrohen edhe në website.</p> <p>takimet ne institucion</p> <p><i>Shtojca 3.7.1 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të parë dhe të dytë universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO raporti i vlerësimit të brendshëm 2017-2018);</i></p> <p><i>Shtojca 3.7.2 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të parë dhe të dytë universiteti Fan S. Noli, Korçë (UNIKO raporti i vlerësimit të brendshëm 2018-2019);</i></p> <p><i>Shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 Departamenti i Informatikës (analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë baze);</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021;</i></p> <p><i>Shtojca 3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit "kriptografi" (pyetësori i stafit akademik model);</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara konkludon që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Të dhënat e mbledhura u komunikohen të gjithë hallkave përfshirëse dhe reflektohen në raportet vjetore të cilat shoqërohen edhe me rekomandimet përkatëse.</p> <p><i>shtojca 1.7.1 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të pare dhe të dytë universiteti fan s. noli, korçë (uniko raporti i vlerësimit të brendshëm 2017-2018);</i></p> <p><i>shtojca 3.7.2 Raporti i vlerësimit të brendshëm për programet e ciklit të pare dhe të dytë universiteti fan s. noli, korçë (uniko raporti i vlerësimit të brendshëm 2018-201);</i></p> <p><i>shtojca 3.8 Raport, analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2019-2020 departamenti i informatikës (analiza vjetore e veprimtarisë së njesise baze);</i></p> <p><i>shtojca 3.13.1 Pyetësor studentor 2021;</i></p> <p><i>3.13.2 Raport analizë në përfundim të vitit akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>shtojca 3.14 Raport analizë në përfundim të modulit "kriptografi" (pyetësori i stafit akademik model);</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në fund të çdo semestri Departamenti i Informatikës organizon me stafin akademik mbledhje ku raportohen edhe të dhënat e mbledhura në pyetësorin në lidhje me programin e studimit. Këto mbledhje shërbejnë për diskutime konkrete në lidhje me masa për përmirësim. GVJ konstaton përmirësime në lidhje me përmbajtjen e lëndës/ modulit, rishikimin e syllabuseve, formave të mësimdhënies për ta bërë me konkrete dhe lehtësisht më të kuptueshme për studentët.</p> <p><i>Takim me pergjegjesin e departamentit te Informatikes;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me perfqesues te zyles se NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UV-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.</p> <p><i>Takimet ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për</p>	<p>GVJ nuk gjeti evidencë në lidhje me takimet informuese të Departamenti të Informatikës me Këshillin Studentor, por në takimet e zhvilluara në institucion u theksua që</p>

informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	komunikimi i drejtpërdrejtë me studentë duke konsideruar numrin e vogël të tyre. Informimi përmes ESSE3, informimi përmes website dhe rrjete sociale janë disa forma që përdoren për të rritur sensibilizimin e studentëve në lidhje me programin mësimor, udhëzimet e reja dhe masat përmirësuese të ndërmarra nga departamenti.			
	<i>Takim me studentet ne institucion;</i> <i>Takim me pergjegjesin e departamentit te Informatikes;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Teknologji Informacioni”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjedise dhe infrastrukturë moderne në funksion të procesit mësimor dhe shërbimeve të tjera për studentët;
2. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është unik në rrethin e Korçës;
3. Përdorimi i sondazheve/anketimeve studentore me efikasitet për vënien në dukje të cilësisë dhe mangësive institucionale dhe të programit të studimit;
4. Fuqizimi i bazës laboratorike bazuar në pjesëmarrje në projekte;
5. Staf akademik dhe ndihmës akademik i përkushtuar në mbështetje të studentëve dhe mësim-dhënies;
6. Afirmim i këtij programi studimi në rrethin e Korçës që duket me rritjen e cilësisë së studentëve të pranuar vit pas vit dhe cilësinë e tyre në dalje.

b. Pika të dobëta:

1. Numër i vogël i stafit akademik me kualifikime dhe grada shkencore;
2. Mungesa e Praktikës Profesionale si lëndë e dedikuar për këtë program studimi;

b. Weak points:

1. Small number of academic staff with scientific degrees and accademic qualifications;
2. Lack of Professional Practice as a subject dedicated to this study program;
3. Not all courses of this study program have holders according to the legal provisions in force;
4. The mandatory literature of the study program, in some subjects is not of the last 5 years;

Recomandations:

1. Increase the qualification of full-time academic staff and encourage the recruitment of young and qualified staf;
2. Increase financial support for scientific research that can also reflect the growth and qualification of academic staf;
3. To enable a feasibility study on the opening of subsequent study cycles as a continuation of the Bachelor program in Information Technology;
4. In the revision of the curricula, to enable the establishment of a subject / module "Professional Practice" to be supported in institutions with which the Fan. S. Noli University has an agreement;
5. Compile subject programs and specify holders according to applicable legal definitions;
6. To update the mandatory literature with publications of the last five years;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X